

Raporti Kombëtar i Vetëpunësimit

GUSHT 2018

Rritja e Kapaciteteve të Rinjtë për Vetëpunësim
Go Green!

Ky raport është hartuar nga Instituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen (IPPM), si pjesë e projekteve të Financuara nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht në qëndrimet e AMSHC-së.

Autorët:

Prof. Dr. Adrian Civici

Dr. Ledjon Shahini

MSc. Kseniia Oleneva

Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij materiali duhet të bëhen pranë zyrave të Institutit për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen ose pranë zyrave të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

në adresat:

Instituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen

Rr. e Elbasanit Nr.8, Tiranë, Shqipëri

Website: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Website: www.amshc.gov.al

E-mail: info@amshc.gov.al

SHKURTIME

AFP	Anketa e Forcave të Punës
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
AZHR	Agjencia për Zhvillim Rajonal
BB	Banka Botërore
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PRE	Programi i Reformave Ekonomike 2018-2020
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PV	Planet Vendore
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020
SNDQV	Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020
SZHAP	Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 2014–2020
SZHBI	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014 - 2020
VSHB	Vlera e Shtuar Bruto
ZRP	Zyrat Rajonale të Punësimit

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	1
2. Tregu i punës në Shqipëri	3
2.1. Analiza e trendeve kryesore	4
2.2. Tregu i Punës dhe Arsimi	23
2.3. Tregu i punës dhe madhësia e ndërmarrjeve	25
2.4. Tregu i punës dhe niveli i Pagave	29
2.5. Tregu i Punës dhe Grupet e Pafavorizuara	30
2.6. Tregu i punës dhe ri-integrimi i emigrantëve të kthyer në vend	31
3. Potencialet e zhvillimit të vetëpunësimit sipas rajoneve	33
3.1. Prioritetet sektoriale për AZHR 1	34
3.2. Prioritetet sektoriale për AZHR 2	36
3.3. Prioritetet sektoriale për AZHR 3	38
3.4. Prioritetet sektoriale për AZHR 4	40
4. Gjetje dhe Rekomandime	43
4.1. Gjetjet	43
4.2. Rekomandime	46
Përkufizime	49
Bibliografi	4-50

Lista e Tabelave

Tabela 1: Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë	26
Tabela 2: Hendeku gjinor i pagës mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve ekonomike	29
Tabela 3: Hendeku gjinor i pagës mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve	30
Tabela 4: Shpërndarja e emigrantëve të kthyer sipas aktiviteteve	32
Tabela 5: Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve, 2016	33

Lista e Grafikëve

Grafiku 1: Popullsia në moshë pune, forca e punës dhe punëkërkues (000), 2013-2017	3
Grafiku 2: Popullsia në moshë pune sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017	4
Grafiku 3: Treguesit e tregut të punës (%).....	5
Grafiku 4: Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017	6
Grafiku 5: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas gjinisë (%)	8
Grafiku 6: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas grupmoshës (%)	8
Grafiku 7: Forca e punës sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017.....	9
Grafiku 8: Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës sipas gjinisë dhe rajoneve, 2017.....	10
Grafiku 9: Shkalla e punësimit sipas gjinisë (%).....	10
Grafiku 10: Shkalla e punësimit sipas grupmoshës (%)	11
Grafiku 11: Punësimi sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017	12
Grafiku 12: Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe rajoneve, 2017	12
Grafiku 13: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë (%).....	13
Grafiku 14: Shkalla e papunësisë sipas grupmoshës (%)	14
Grafiku 15: Papunësia sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017.....	15
Grafiku 16: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe rajoneve, 2017	15
Grafiku 17: Punësimi sipas sektorëve ekonomikë për periudhën 2011-2013 (%).....	16

Grafiku 18: Punësimi sipas sektorëve ekonomikë për periudhën 2015-2017 (%).....	17
Grafiku 19: Punësimi sipas rajoneve dhe sektorit ekonomik, 2017.....	17
Grafiku 20: Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor	18
Grafiku 21: Numri i punëkërkuessve dhe popullsia në moshë pune (15-19 vjeç), 2001-2017	19
Grafiku 22: Numri i punëkërkuessve dhe popullsia në moshë pune (20-34 vjeç), 2001-2017	19
Grafiku 23: Numri i punëkërkuessve dhe popullsia në moshë pune (35-64 vjeç), 2001-2017	20
Grafiku 24: Peshë e punëkërkuessve sipas gjinisë dhe numri i tyre.....	20
Grafiku 25: Peshë e punëkërkuessve sipas grupmoshës.....	21
Grafiku 26: Peshë e punëkërkuessve sipas nivelit arsimor	22
Grafiku 27: Punësimi sipas madhësisë së ndërmarrjeve.....	25
Grafiku 28: Peshë e ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve, 2017.....	26
Grafiku 29: Peshë e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik, 2017.....	28
Grafiku 30: PBB/frymë sipas qarqeve në mijë lekë, 2016.....	33
Grafiku 31: Struktura e VSHB-së për AZHR 1, 2016.....	34
Grafiku 32: Struktura e VSHB-së për AZHR 2, 2016.....	36
Grafiku 33: Struktura e VSHB-së për AZHR 3, 2016.....	39
Grafiku 34: Struktura e VSHB-së për AZHR 4, 2016.....	41

Përmbledhje

Raporti kombëtar i vetëpunësimit i përgatitur në kuadër të projektit “Rritja e Kapaciteteve të Rinjtë për Vetëpunësim. Go Green!”, synon të sjell në mënyrë të strukturuar situatën e punësimit në Shqipëri me një fokus të veçantë të vetëpunësimit të rinjve, si dhe të faktorëve kryesor pengues të zhvillimit gjithëpërfshirës. Kjo analizë është mundësuar duke u referuar një sërë dokumenteve strategjik në nivel kombëtar dhe vendor, planeve të zhvillimit, raporteve statistikore dhe studimeve të thelluara të bëra në fusha të ndërlidhura me vetëpunësimin e rinjve në rajone të ndryshme të vendit.

Nisur nga struktura e zhvillimit ekonomik të vendit, ku ka një përqendrim të lartë të ekonomisë së vendit në qarkun e Tiranës, qark i cili kontribuon me rreth 40 %¹ të PBB-së vendit, dhe gjithashtu rreth 39%² të bizneseve të formës ligjore person fizik, është shumë e rëndësishme që analiza të bëhet sipas rajoneve të zhvillimit ekonomik. Trajtimi i analizave të deritanishme përgjithësisht i referohet nivelit kombëtar, sipas qarqeve ose në nivel bashkie duke mos marrë në konsideratë studimin e faktorëve ndikues në nivelin e vetëpunësimit në një nivel rajonal zhvillimi, edhe pse një i tillë ekziston në vend referuar ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë qëllim vlen të theksohet se kjo analizë është e para që ka mundur të agregojë një sërë treguesish socio-ekonomik sipas këtij kategorizimi, nivel i cili mundëson studime me gjithëpërfshirëse të tregut të vetëpunësimit dhe gjithashtu mundëson rekomandime më të qarta të ndërlidhjeve sektoriale rajonale të zhvillimit ekonomik dhe të qartësimit të nevojave për sipërmarrje të reja në nivel rajonal.

Ky kategorizim rrjedh si domosdoshmëri për të ndërtuar plane zhvillimi ekonomik dhe strategji rajonale punësimi në konsistencë me strategjitë kombëtare dhe sektoriale të vendit. Koordinimi në nivel vertikal i planeve të zhvillimit mundëson krijimin e bizneseve të cilat kanë mundësi më të larta të jenë të suksesshme, të kenë më tepër akses për të gjetur fonde financimi dhe mbështetje nga projekte të ndryshme të cilat nxisin iniciativa të reja të zhvillimit të biznesit.

Në këtë aspekt analiza e faktorëve socio-ekonomik sipas ndarjes rajonale të zhvillimit të vendit, zë një pjesë të rëndësishme në raportin kombëtar të vetëpunësimit. Për të bërë të mundur këtë analizë janë studiuar një sërë strategjish në nivel kombëtar si dhe strategjitë sektoriale. Një pjesë të rëndësishme të analizës e zënë edhe planet e zhvillimit të përgatitura nga bashkitë, të cilat janë pjesë përbërëse e rajoneve të zhvillimit. Kjo analizë është bërë për të mundësuar nxjerrjen e faktorëve kryesor që mund të integrohen në rajonet përkatëse të zhvillimit.

Referuar të dhënave më të fundit të tregut të forcave të punës në vend, Shqipëria karakterizohet nga një normë e lartë e popullsisë në moshë pune jashtë fuqisë punëtore, nivel i cili referuar vitit 2017 arrin normën e 33.2%. Analizuar kjo shifër sipas gjinisë vihet re një shpërndarje shumë e

¹ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_NA_NAY2/NAR_01/?rxid=c7a07ea3-7138-4791-b67a-2bcd849da17c

² <http://www.instat.gov.al/media/4149/regjistri-i-ndermarrjeve-2017.pdf>

pa-barabartë mes meshkujve dhe femrave, ku për të njëjtën periudhë përqindja e femrave në moshë pune jashtë fuqisë punëtore arrin në 42.3% ndërsa për meshkujt në 24.2%.³

Në këto kushte analiza e faktorëve që ndikojnë në vetëpunësimin e të rinjve nuk duhet analizuar vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik por edhe të kohezionit gjinor. Përdorimi i ideve inovatore në krijimin e bizneseve të reja në trajtën e vetëpunësimit, ka më shumë gjasa të jetë më gjithëpërfshirës dhe me një barazi më të lartë gjinore.

Një nga problemet themelore, i njohur ndërkombëtarisht lidhur me vetëpunësimin, apo sipërmarrjet e vogla është problemi i financimit. Në ditët e sotme një mbështetje të madhe po marrin sipërmarrjet e vogla me fokus bizneset e gjelbra, të cilat jo vetëm që mundësojnë zhvillim socio-ekonomik por në të njëjtën kohë sigurojnë edhe një zhvillim të qëndrueshëm pa kosto të mëdha për brezat e ardhshëm, një nga problemet më kryesore që ekonomistët e ditëve të sotme ngrenë në vazhdimësi.

Raporti kombëtar i vetëpunësimit pikërisht synon që nëpërmjet analizave të integruara të të dhënave dhe dokumenteve të ndryshëm të pasqyrojë mundësi reale të vetëpunësimit të të rinjve në rajone të ndryshme të vendit dhe në të njëjtën kohë të nxjerrë një sërë rekomandimesh mbi mundësi krijimi të sipërmarrjeve të cilat kanë më tepër mundësi për gjetje financimi dhe në të njëjtën kohë që mundësojnë kohezion gjinor në vend.

³ <http://www.instat.gov.al/media/4436/tregu-i-punes-2017.pdf>

Gjetjet kryesore

Gjetjet e dala në raportin kombëtar të vetëpunësimit janë mbështetur mbi analiza të detajuara të një sërë raportesh, strategjish dhe planesh zhvillimi si dhe në opinionin e një sërë ekspertësh të fushës. Përsa i përket disa nga gjetjeve më kryesore janë:

- Përsa i përket punës dhe punëkërkesës të grupmoshës 20-34 vjeç ka ardhur në rënie gjatë viteve të fundit.
- Ka një diferencë të lartë të pjesëmarrjes në forcat e punës me bazë gjinore, diferencë e cila është shumë e theksuar sidomos te kategoria e të vetëpunësuarve.
- Shqipëria karakterizohet nga një treg pune me diskriminim gjinor në paga.
- Ka mospërputhje mes kërkesës dhe ofertës në tregun e punës, kjo më e theksuar për individët me arsim të lartë.
- Punësimi mes grupimit të ndërmarrjeve është në nivele të barabarta mes atyre të vogla dhe atyre të mëdha edhe pse grupi i parë përbën pjesën më të madhe të numrit të ndërmarrjeve.
- Integrimi i emigrantëve të kthyer në tregun e punës mbetet një problem i vazhdueshëm dhe kërkon masa konkrete për të kaluar këtë kategori nga ofrues të punës në kërkues të punës.

E rëndësishme është analiza e avantazheve krahasuese që ka çdo rajon, pasi këto avantazhe duhet të shihen si mundësitë potenciale ku të rinjtë duhet të synojnë të drejtohen në të ardhmen. Përsa i përket avantazheve ekonomike sipas rajoneve mund të themi se:

Për rajonin e parë zhvillimi duhet të fokusohet në:

- Zhvillimin e sektorit turistik, kryesisht turizmit malor dhe atij natyror.
- Mundësinë për të zhvilluar pylltarinë, sidomos për rritjen e drurëve për ngrohje.
- Mundësinë për të zhvilluar Industrinë nxjerrëse, përpunimit, energjisë dhe ujit.

Për rajonin e dytë zhvillimi duhet të fokusohet në:

- Zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë, transportit dhe hotelerisë.
- Zhvillimi i bizneseve novative në shërbim të bizneseve të tjera.
- Mundësinë e ngritjes dhe promovimit të një sistemi me cilësi të lartë të prodhimit të ushqimit.
- Zhvillimi në sektorin e ndërtimit.

Për rajonin e tretë zhvillimi duhet të fokusohet në:

- Zhvillim e sektorit të bujqësisë dhe mundësinë e zhvillimit të bujqësisë organike në veçanti.
- Rritjen e përdorimit të pasurive natyrore e trashëgimisë kulturore të rajonit.

- Zhvillim e sektorit të industrinë nxjerrëse, përpunuese, energjisë dhe ujit.

Për rajonin e katërt zhvillimi duhet të fokusohet në:

- Zhvillimin e mëtejshëm të turizmit, falë pasurive natyrore, monumenteve të kulturës dhe zonave arkeologjike..
- Mundësinë për zhvillim të mëtejshëm të degës së tregtisë, transportit dhe hotelërisë, lidhur kryesisht me pozicionin gjeografik.
- Rritjen e sipërfaqes së tokave bujqësore të shfrytëzuara dhe zbatimit të praktikave të mira bujqësore.
- Potencialin e shfrytëzimit të pasurive në hidrokarbure dhe hidrocentrale.

1. Hyrje

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës është një nga objektivat dhe sfidat prioritare për çdo vend, të cilat nuk mund të arrihen pa zhvillimin e sektorëve potencialë ekonomik dhe zhvillimin e kapitalit human sipas këtyre strukturave/tregjeve potenciale të punës.

Reduktimi i papunësisë në përgjithësi dhe i të rinjve në veçanti është sot sfida më e vështirë në nivel lokal, kombëtar dhe global. Kostot e papunësisë janë individuale, familjare, kombëtare dhe globale. Cënimi i kohezionit social nga niveli i lartë i papunësisë dhe i pabarazisë ushqen sot skeptikët dhe radikalët, prodhon pakënaqësi shoqërore dhe jostabilitet politikë.

Në kushtet e periudhave të gjata me inflacion të ulët, rritja e punësimit është sot një prioritet i rëndësishëm shoqëror. Format e punësimit dhe tregjet potenciale të punës tentojnë të jenë në ndryshime dinamike të shpejta dhe të thella. Një prej tyre është edhe vetëpunësimi. Kjo është sot edhe sfida më e madhe e programeve të edukimit, trajnimit dhe ritrajnimit, të cilat duhet të edukojnë dhe përgatisin individë që krijojnë biznes dhe jo thjesht punëkërkues. Ato duhet të përgatisin studentë për punë që akoma nuk ekzistojnë (për shembull, rreth 85% e bizneseve të vitit 2030 sot ende nuk ekzistojnë⁴).

Kriza globale e vitit 2007 preku më shumë vendet të cilat nuk kishin ndërmarrë reformat strukturore të tregjeve të punës dhe sidomos në fushën e arsimit për të rritur mobilitetin, përshtatjen e kapitalit human dhe social sipas sektorëve më produktivë. Këto reforma, së bashku me efektet pozitive të teknologjive të reja, rrëzojnë barrierat gjeografike dhe rrisin fleksibilitetin dhe sigurinë për të rinjtë në tregje në rritje dhe konkurruese.

Në këtë aspekt punësimi nuk është vetëm një nga sfidat kryesore në zhvillimin gjithëpërfshirës, por edhe strukturimi i krahut të punës në sektorët potencial kthehet në domosdoshmëri. Politikat e punësimit duhet të ecin në konsistencë të plotë me strategjitë kombëtare në mënyrë që të mundësohet një normë sa më e ulët e papunësisë.

Rritja e punësimit apo/dhe vetëpunësimit ngelet një nga sfidat socio-ekonomike më të rëndësishme në nivel kombëtar në Republikën e Shqipërisë. Përkrah analizës së tregut të punës në nivel kombëtar, për të vlerësuar mundësitë dhe pengesat me të cilat duhet të përballen individët për të gjetur një punë, është e rëndësishme që të studiohet tregu i punës edhe në nivel rajonal, duke marrë në konsideratë veçoritë që ekzistojnë në secilin prej rajoneve dhe që diktojnë jo vetëm norma të ndryshme të treguesve të punësimit, por edhe lloje të ndryshme të aktiviteteve ekonomike në të cilët individët punësohen.

Shqipëria ka norma relativisht të larta të vetëpunësimit në raport me numrin total të të punësuarve, krahasuar kjo edhe me vendet e rajonit, ku për vitin 2017 kjo peshë llogaritet në 35.4% të të punësuarve në total. Sipas Bankës Botërore, evidencat tregojnë që vendet me norma më të larta të të vetëpunësuarve në raport me të punësuarit në total janë ato vende që mbështeten kryesisht në sektorin e agrikulturës. Për më tepër, Shqipëria renditet ndër ato vende që peshën më të madhe të të vetëpunësuarve e përbëjnë individët me arsim të ulët. Konkretisht struktura e

⁴ https://www.huffingtonpost.ca/2017/07/14/85-of-jobs-that-will-exist-in-2030-haven-t-been-invented-yet-d_a_23030098/

të vetëpunësuarve të kategorizuar sipas nivelit arsimor për vitin 2017 përbëhet nga 56.0% nga individë me arsim të ulët, 37.8% nga ata me arsim të mesëm dhe vetëm 6.2% nga të vetëpunësuar me arsim të lartë.⁵

Sipas ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, që nga 31 korriku i vitit 2014, vendi ndahet në 61 bashki, pjesë e 12 qarqeve⁶ dhe më tej agregohen në 4 rajone. Rajoni i parë (AZHR 1) përbëhet nga Qarku i Kukësit, Lezhës, Shkodrës; rajoni i dytë (AZHR 2) përbëhet nga Qarku i Dibrës, Durrësit, Tiranës; rajoni i tretë (AZHR 3) përbëhet nga Qarku i Beratit, Elbasanit, Korçës; rajoni i katërt (AZHR 4) përbëhet nga Qarku i Fierit, Gjirokastrës, Vlorës. Përkrah analizës së tregut të punës në nivel kombëtar, për të vlerësuar mundësitë dhe pengesat me të cilat duhet të përballen individët për të gjetur një punë, është e rëndësishme që të studiohet tregu i punës edhe në nivel rajonal.

⁵ Banka Botërore (2018): "*Balkani Perëndimor, Trendet e Tregut të Punës, 2018*". The Vienna Institute for International Economic Studies. E aksesueshme: <http://documents.worldbank.org/curated/en/565231521435487923/pdf/124354-WP-P158508-PUBLIC-16-3-2018-10-13-39-WBLabormarkettrends.pdf>

⁶ <http://www.reformaterritoriale.al/reforma/pse>


2. Tregu i punës në Shqipëri

Studimi i tregut të punës për rastin e Shqipërisë është bërë duke marrë në konsideratë një periudhë 10 vjeçare, pra referuar periudhës 2008-2017 në mënyrë që të tregojë sa më qartë ndryshimet strukturore që kanë ndodhur në vend lidhur me fenomenin e punësimit dhe për të nxjerrë disa konkluzione të eficientës afatgjatë të politikave të ndërmarra deri tani në nivele vendore dhe qendrore. Analizat krahasuese rajonale janë fokusuar kryesisht në periudhën e fundit të marrë në shqyrtim për të qenë në konsistencë me zhvillimet më koherente socio-ekonomike të rajoneve specifike në vend.

E rëndësishme është që kur flitet për trendet e punësimit, të bëhen krahasime ndërmjet tyre dhe trendit të popullsisë në moshë punë. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur ecuria e popullsisë në moshë pune (15 – 64 vjeç) për periudhën kohore 2013-2017, si dhe ecuria e forcës së punës dhe punëkërkuessve të papunë të regjistruar për periudhën respektive. Vihet re se popullsia në moshë pune ka pësuar një trend rënës në kohë, duke arritur në vlerën minimale të periudhës në vitin 2017 me 1,975 mijë banorë konkretisht. Kjo është shoqëruar me një trend përgjithësisht rënës të individëve punëkërkuess dhe më një trend rritës të forcës së punës në kohë.

Veçanërisht pas vitit 2014 numri i personave që bëjnë pjesë në forcën e punës ka ardhur në rritje dhe numri i punëkërkuessve ka ardhur në rënie, duke arritur në 1,185 mijë dhe 89 mijë banorë respektivisht për vitin 2017. Të dhënat tregojnë se pavarësisht rënies së popullsisë në moshë pune, më shumë individë kanë shprehur interesin për t'u përfshirë në forcën e punës me kalimin e kohës, duke treguar për një rritje të aktivizimit të tyre në tregun e punës në Shqipëri.

Grafiku 1: Popullsia në moshë pune, forca e punës dhe punëkërkuess (000), 2013-2017




Burimi: INSTAT, 2018

Përpara se të analizohen treguesit e punësimit dhe të papunësisë, është e rëndësishme të bëhet një paraqitje e numrit të popullsisë në moshë pune për të treguar se në cilin rajon është përqendruar pjesa më e madhe e kësaj popullsie. Për vitin 2017 numërohen 2 376 248 individë në moshë pune

sipas të dhënave të INSTAT. Nga grafiku i mëposhtëm duket qartë se pjesa më e madhe e popullsisë në moshë pune është përqendruar në AZHR 2, konkretisht 42% e kësaj popullsie. Kjo vjen për shkak të përqendrimit të popullsisë në Qarkun e Tiranës, e cila përbën 28% të popullsisë totale në moshë pune.

Tri rajonet e tjera përbëjnë pesha më të ulëta të kësaj popullsie, përkatësisht 15%, 23% dhe 20%. Përsa i përket popullsisë sipas gjinisë, me përjashtim të AZHR 4, ku meshkujt përbëjnë gati 51% të kësaj popullsie, në tri rajonet e tjera meshkujt dhe femrat përbëjnë pesha të barabarta, gjë që tregon se peshat jo të barabarta të numrit të të punësuarve, të papunëve dhe të popullsisë ekonomikisht jo aktive për meshkujt dhe femrat nuk vijnë për shkak të raporteve të ndryshme në popullsinë totale në moshë pune, por për shkak të sjelljeve të tyre të ndryshme në tregun e punës.

Grafiku 2: Popullsia në moshë pune sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve


2.1. Analiza e trendeve kryesore

Referuar të dhënave të AFP-së shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës ndjek një trend pothuajse konstant përgjatë viteve 2008 – 2017. Në vitin 2008, pjesëmarrja ishte rreth 53% e individëve të aftë për punë, duke arritur nivelin maksimal në vitin 2011, me rreth 60%. Pjesëmarrja në forcat e punës është përkeqësuar në dy vitet në vazhdim, ku në vitin 2013 arrihet edhe shkalla më e ulët e pjesëmarrjes në forcat e punës për periudhën e marrë në shqyrtim, konkretisht 52.4%. Pas vitit 2013, ky tregues është përmirësuar vazhdimisht duke arritur në shkallën 58% në vitin 2017.

Shkalla e punësimit ka ecur në të njëjtin trend me atë pjesëmarrjes në forcat e punës. Viti 2011 shënon vitin me shkallën më të lartë të punësimit gjatë periudhës 2008-2017, në një nivel prej 51.9%. Pas 2013, shkalla e punësimit është përmirësuar vit pas viti, duke shënuar 50.3% për vitin 2017. Shkalla e papunësisë ka ruajtur një trend pothuajse konstant përgjatë viteve 2008 – 2012, në intervalin e 13% – 14% dhe më pas ka filluar të rritet për dy vitet në vazhdim, duke arritur maksimumin në vitin 2014 me 17.5% për të filluar përsëri një trend ulës dhe në vitin 2017 ka

arritur në nivelin e 13.7%, nivel i cili është pothuajse i barabartë me mesataren e pesë vjeçarit të parë të marrë në studim, pra me periudhën 2008-2012.

Grafiku 3: Treguesit e tregut të punës (%)



Burimi: INSTAT, 2018

Sipas raportit “*Tregu i punës, 2017*” të INSTAT, një pjesë e madhe e popullsisë shqiptare rezulton ekonomikisht jo-aktive, ku vetëm për vitin 2017 ajo llogaritet në 33.2% për grupmoshën 15-64 vjeç, nga të cilët, 37.9% dominohen nga nxënës/studentët. 8.2% e kësaj grupmoshe për 2017 nuk kërkojnë punë pasi mendojnë se nuk ka punë të disponueshme për ta.


Pesha e personave ekonomikisht jo-aktivë për shkak të dekurajimit të tyre për të mos gjetur punë të grupmoshës 15-64 vjeç për vitin 2017 llogaritet në 11.6%. Peshën më të madhe të personave ekonomikisht jo-aktivë e zënë nxënësit/studentët ose personat në trajnim të mëtejshëm, konkretisht me një peshë prej 53.1%, ku 6.1% të kësaj kategorie e përbëjnë personat në pension ose në pension të parakohshëm, dhe vetëm 2.1% e tyre rezultojnë jo-aktivë për shkak të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësiave familjare.⁷

Përveç studimit të treguesve të punësimit dhe të papunësisë, e rëndësishme është gjithashtu të studiohet popullsia ekonomikisht jo aktive, pra ajo pjesë e popullsisë e cila nuk është as e punësuar, por as në kërkim të një pune. Në grafikun e mëposhtëm vihet re numri relativisht i lartë i kësaj popullsie në AZHR 2 (kjo për faktin e numrit më të madh të popullsisë në këtë rajon) në krahasim me rajonet e tjera, duke përbërë 46% të popullsisë ekonomikisht jo aktive në nivel kombëtar. Vihet re gjithashtu se femrat janë ato që përbëjnë pjesën më të madhe të kësaj popullsie në secilin prej rajoneve, veçanërisht në rajonin e katërt, duke arritur në 62%. Këto

⁷ INSTAT (2017): “*Tregu i Punës, 2016*”. Tiranë. E aksesueshme: <http://instat.gov.al/media/4154/tregu-i-punes-2017.pdf>

shifra tregojnë për tërheqjen e femrave nga tregu i punës, duke treguar për potencialin e pashfrytëzuar që vjen nga mospërfshirja e tyre në tregun e punës.

Grafiku 4: Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Trendi për shkallën e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas gjinisë ka ecur në të njëjtën linjë me atë të popullsisë, por vihet re një shkallë më e lartë pjesëmarrjeje e meshkujve gjatë gjithë periudhës. Kështu, femrat rezultojnë të jenë më të tërhequra nga tregu i punës krahasuar me meshkujt. Në vitin 2008, shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës për meshkujt ishte 62% ndërsa për femrat 46%, një hendek relativisht i madh, i cili ruhet përgjatë viteve dhe në vitin 2017 shkalla e pjesëmarrjes së meshkujve në forcën e punës rezulton rreth 67%, ndërsa për femrat rreth 50%.

Ajo që vlen për tu përmendur është rritja më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës së femrave krahasuar me meshkujt. Kështu nëse krahasojmë vitin 2017 me vitin 2008, pra krahasimi kohor me një dekadë vihet re që pjesëmarrja e meshkujve është rritur nga 61.7 në 66.8 ose ndryshe me 8.3% rritje ndërsa për femrat nga 45.7% në vitin 2008 në 49.8% në vitin 2017 ose një rritje me 9%. Por edhe pse ka pasur një rritje më të lartë të femrave të përfshira në forcat e punës, kjo është një rritje relativisht e vogël e cila nuk siguron mundësinë drejt një kohezioni gjinor në periudhën afatgjatë duke marrë në konsideratë faktin që gjatë dhjetë vjetëve analizë, rritja ka qenë me vetëm 0.7 % më e lartë dhe diferenca në pjesëmarrje të forcave të punës është me rreth 17 % për vitin 2017. Me këto ritme pra do të kërkohet një periudhë shumë e gjatë që të shkohet drejt një konvergjence gjinore.

Kutia 1:

Kur punojnë më shumë gra, kjo do të thotë më shumë fuqi punëtore të përfshira në procesin e prodhimit e si rrjedhim ekonomitë rriten. Sektorët ekonomik janë të mbështetur mbi kapitalin human dhe fizik për ofrimin e të mirave dhe shërbimeve që ata prodhojnë në këtë aspekt përfshirja e më shumë punonjësve do të thotë më shumë kapital e si rrjedhim më shumë prodhim. Një rritje në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore të grave dhe vajzave ose një reduktim në hendekun midis pjesëmarrjes së grave dhe burrave në fuqinë punëtore rezulton në rritje ekonomike më të shpejtë dhe të qëndrueshme.

Evidencat nga një sërë vendesh tregojnë se kur rritet pesha që zënë të ardhurat e siguruara nga gratë dhe vajzat në të ardhurat totale familjare, pavarësisht nëse vijnë nga puna e tyre apo nga transfertat kesh, ndryshon mënyra e përdorimit të tyre dhe sjell një sërë përfitimesh socio-ekonomike. Rritja e të ardhurave të siguruara nga femrat sjell një nivel edukimi më të lartë të fëmijëve, një planifikim më të mirë të familjeve, reduktim të vdekshmërisë foshnjore, etj. Nisur nga përfitimet që sjell integrimi i femrave në shoqëri dhe në tregun e punës më konkretisht, ky fenomen është bërë dhe një nga objektivat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të mijëvjeçarit, dhe më konkretisht objektivi i 5-të nga 17 objektiva që janë në total.¹ Pra barazia gjinore konsiderohet si një nga mundësitë më potenciale që mund të sigurojë zhvillimin ekonomik të gjeneratave të ardhshme.

Gratë vazhdojnë të marrin pjesë në tregjet e punës në baza të pabarabarta me burrat dhe për më tepër ato paguhen më pak se ata. Gratë në shumicën e vendeve fitojnë mesatarisht vetëm 60% deri në 75% të pagave të meshkujve. Faktorë kontribues përfshijnë faktin që gratë kanë më shumë gjasa të jenë të punësuar me paga dhe punëtore të papaguara të familjes; që gratë kanë më shumë gjasa të angazhohen në aktivitete me produktivitet të ulët dhe të punojnë në sektorin informal, me më pak lëvizshmëri në sektorin formal sesa meshkujt; pikëpamja e grave si vartëse ekonomike; dhe gjasat që gratë të jenë në sektorët e paorganizuar ose të mos jenë të përfaqësuar në sindikata.

Është llogaritur që gratë mund të rrisin të ardhurat e tyre në nivel global deri në 76% nëse hendeku i pjesëmarrjes në punësim dhe hendeku i pagave midis grave dhe burrave eliminohet, duke treguar kështu për rëndësinë e madhe që ka përfshirja e grave në tregun e punës.²

Referenca:


¹ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals.html>

² <http://www.unwomen.org/en/what-we-do/economic-empowerment/facts-and-figures>

Për të mundësuar konsistencën gjinore në tregun e punës është e domosdoshme që shteti apo institucione të tjera që mbështesin vetëpunësimin, nëpërmjet mbështetjes financiare të drejtpërdrejtë apo studimeve të tregut dhe planeve të biznesit të ndërmarrin politika të cilat kanë në bazë edhe barazinë gjinore dhe jo vetëm analiza ekonomike të cilat mund të sjellin rritje më të

shpejtë në periudhën afatshkurtër por nuk sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në periudhën afatgjatë.


Grafiku 5: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas gjinisë (%)



Burimi: INSTAT, 2018

Shkalla e pjesëmarrjes sipas grupmoshave tregon në të njëjtin trend me atë të totalit të popullsisë përgjatë viteve të analizuar, por vihet re se shkalla e pjesëmarrjes për grupmoshën 15-29 vjeç rezulton gjatë gjithë periudhës me një diferencë relativisht të madhe nën shkallën për grupmoshën 30-64 vjeç.

Grafiku 6: Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës sipas grupmoshës (%)




Burimi: INSTAT, 2018

Pra, të rinjtë përbëjnë një numër të vogël të forcës së punës krahasuar me të rriturit. Kështu, në vitin 2008, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për grupmoshën 15-29 vjeç ishte 42%, ndërsa shkalla e pjesëmarrjes për moshën 30-64 vjeç ishte 72%, pra rreth 30 pikë përqindje më e lartë. Përgjatë viteve, diferenca ndryshon shumë pak, por në vitin 2016 shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës të të rinjtë ulet në 46% ndërsa ajo e të rriturve qëndron në 77% duke e thelluar më tepër diferencën.

Në grafikun 7 paraqitet numri i individëve që bëjnë pjesë në forcën e punës për vitin 2017 për secilin nga 4 rajonet e Shqipërisë, të ndarë edhe sipas gjinisë për të treguar dallimet gjinore të këtij treguesi. Sikurse vihet re, peshën më të madhe të forcës së punës për 2017 e përbën AZHR 2, ndërsa atë më të ulët e përbën AZHR 1. Në secilin prej këtyre rajoneve meshkujt janë ata që përbëjnë pjesën më të madhe të forcës së punës në krahasim me femrat, konkretisht 56% në AZHR 1 dhe 3, 58% në AZHR 2 dhe 59% në AZHR 4.

Grafiku 7: Forca e punës sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017




Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Meqenëse popullsia në moshë pune nuk është e shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjithë rajonet e vendit, numri i personave që bëjnë pjesë në forcën e punës nuk tregon shumë për përfshirjen e tyre në tregun e punës sipas çdo rajoni. Për këtë arsye është llogaritur shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës, jo vetëm e ndarë për secilin rajon, por edhe e kategorizuar sipas gjinive. Rajoni me shkallën më të lartë të pjesëmarrjes në forcën e punës është AZHR 3 me 62% të totalit të popullsisë në moshë pune, më pas renditet AZHR 4 me 61%, AZHR 1 me 58% dhe në fund AZHR 2 me 55% pjesëmarrje.

Pavarësisht se AZHR 2 përmban numrin më të lartë të individëve që përbëjnë pjesë në forcën e punës, shkalla e ulët e këtij treguesi tregon që një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së këtij rajoni janë ekonomikisht jo aktivë. Vihet re se meshkujt janë ata që përbëjnë pjesën më të madhe të forcës së punës në secilin prej rajoneve në krahasim me femrat, veçanërisht në rajonin e dytë

dhe të katërt ky hendek është më i theksuar, ku meshkujt përbëjnë 18% dhe 20% më shumë pjesë në forcën e punës se femrat.


Grafiku 8: Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës sipas gjinisë dhe rajoneve, 2017



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Të kategorizuar sipas gjinisë, shkalla e punësimit për femrat dhe meshkujt ka ecur në të njëjtin trend me atë të të punësuarve totalë, por ajo që vihet re është se shkalla e punësimit për meshkujt rezulton gjatë gjithë periudhës së analizuar më e lartë se ajo e femrave, duke treguar që meshkujt janë më aktivë në tregun e punës.

Grafiku 9: Shkalla e punësimit sipas gjinisë (%)




Burimi: INSTAT, 2018

Krahasuar me vitin 2008, shkalla e punësimit është rritur për të dyja gjinitë në vitin 2017, duke ngushtuar edhe hendekun për këtë tregues sipas gjinive. Kështu, nga një hendek prej 14.6% në vitin 2008, në vitin 2017 shkalla e meshkujve të punësuar është 13.6% më e lartë se ajo e femrave.

Studimi i Bankës Botërore mbi trendet e tregut të punës në vendet e Ballkanit Perëndimor i viti 2018, nxjerr në pah se jo vetëm punësimi në përgjithësi, por edhe vetëpunësimi në veçanti është më i përhapur te meshkujt sesa te femrat. Për më tepër, hendeku në raportin e të vetëpunësuarve si raport i numrit total të të punësuarve të moshës 15-64 vjeç është më i larti në Shqipëri në krahasim me vendet e rajonit. Konkretisht meshkujt e vetëpunësuar rezultojnë të përbëjnë rreth 42% të të punësuarve total meshkuj, ndërsa femrat vetëm 27% të të punësuarve të femrave në total.

Përsa i përket ndarjes sipas grupmoshave, rezulton se numrin më të lartë të të punësuarve e përbëjnë personat e grupmoshës 30-64 vjeç. Për më tepër me rënien e shkallës së punësimit total në periudhën 2011-2013, shkalla e punësimit të grupmosha e të rinjve ka pësuar rënie më të ndjeshme se ajo e të rriturve. Studimet tregojnë se të rinjtë e kanë më të vështirë për të mbajtur një punë krahasuar me të rriturit kur punësimi total bie.

Grafiku 10: Shkalla e punësimit sipas grupmoshës (%)




Burimi: INSTAT, 2018

Në grafikun 11 paraqitet numri i të punësuarve sipas rajoneve dhe gjinisë për vitin 2017. Në rajonin e dytë përqendrohet numri më i madh i të punësuarve, i cili shkon në 471 639 të punësuar, duke përbërë rreth 40% të të punësuarve në nivel kombëtar. Vlen gjithashtu të theksohet se shumica e individëve janë të punësuar në Qarkun e Tiranës, duke përbërë rreth 65% të totalit të të punësuarve në AZHR 2 dhe mbi 25% të të punësuarve në nivel kombëtar. Këto shifra tregojnë edhe arsyen pse numri i të punësuarve në AZHR 2 është më i lartë se në rajonet e tjera.

Përsa i përket punësimit sipas gjinisë, në secilin prej rajoneve meshkujt janë ata që përbëjnë peshën më të madhe të të punësuarve në krahasim me femrat. Ky hendek është më i madh në AZHR 4, ku meshkujt përbëjnë 59% të të punësuarve në krahasim me femrat që përbëjnë vetëm 41%.


Grafiku 11: Punësimi sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet shkalla e punësimit, si për femrat dhe për meshkujt në secilin prej 4 rajoneve të Shqipërisë për vitin 2017. Ajo që vihet re nga grafiku është se në secilin rajon meshkujt janë ata që kanë shkallën më të lartë të punësimit në krahasim me femrat. Ky hendek është më i lartë në AZHR 4, ku shkalla e punësimit për meshkujt është 16% më e lartë se ajo e femrave.

Grafiku 12: Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe rajoneve, 2017




Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Shkallën më të lartë të punësimit e përbën AZHR 3 me 56%, ku për meshkujt dhe për femrat llogaritet në 63% dhe 49% përkatësisht. Ndërsa shkallën më të ulët të punësimit e përbën AZHR 2 me 47%, ku për meshkujt dhe për femrat llogaritet në 54% dhe 40% përkatësisht. Pra, pavarësisht se në terma absolutë AZHR 2 punëson pjesën më të madhe të individëve në nivel kombëtar, shkalla e punësimit është më e ulët në krahasim me 4 rajonet e tjera, gjë që shkaktohet edhe nga numri i lartë i popullsisë në moshë të punë të përqendruar në këtë rajon në krahasim me pjesën tjetër të vendit.

Ndryshe nga sa ka ndodhur me shkallën e pjesëmarrjes në forcat e punës dhe me atë të punësimit, peshën më të madhe në shkallën e papunësisë e kanë zënë herë meshkujt e herë femrat, edhe pse që nga 2012 duket se meshkujt e kanë pasur më të vështirë të gjejnë një punë, sikurse mund të vihet re nga grafiku. Në vitet 2008-2011 femrat zinin peshën më të lartë të papunësisë në krahasim me meshkujt, ndërsa në vitet pasuese rezultoi e kundërta. Gjatë periudhës 2012-2014, papunësia ka ardhur në rritje për të dyja gjinitë, ku vihet re edhe një hendek i theksuar ndërmjet femrave dhe meshkujve. Në vitin 2015 papunësia vazhdon të rritet për femrat, por shënon ulje për meshkujt, duke shkaktuar kështu një shkallë të barabartë papunësie për të dyja gjinitë. Gjatë dy viteve të fundit vihet re përmirësim i treguesit, si për femrat edhe për meshkujt, por duke shkaktuar sërish rritje të hendek ndërmjet gjinive, konkretisht në vitin 2017 shkalla e papunësisë për meshkujt ka qenë 2% më e lartë se për femrat.

Grafiku 13: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë (%)




Burimi: INSTAT, 2018

Nga grafiku 14 vihet re se shkalla e papunësisë për të dy grupmoshat ka ecur gati në të njëjtin trend me atë të popullsisë totale, por luhatjet për grupmoshën e të rinjve kanë qenë më të theksuara se për grupmoshën e të rriturve. Të dhënat tregojnë që shkallën më të lartë të papunësisë gjatë gjithë periudhës në analizë e ka përbërë grupmosha 15-29 vjeç. Që pas 2011 e

deri në 2016 vihet re një rritje e konsiderueshme e papunësisë të rinjtë. Në vitin 2014 shënohet rritja më e madhe e shkallës së papunësisë të rinjtë me 19.5%, ndërsa një vit më vonë shënohet vlera më e madhe e shkallës së papunësisë të kjo grupmoshë me 33.2%. Edhe pse shkalla e papunësisë ka rënë në dy vitet e fundit për të gjitha grupmoshat, papunësia të rinjtë vazhdon të mbetet në nivele të larta, duke e bërë kështu gjetjen e mënyrave për të rritur punësimin e rinjve një sfidë kyçe për shoqërinë shqiptare.

Shkalla e papunësisë sipas grupmoshave pohon se vështirësitë më të mëdha në tregun e punës në vend i hasin grupmoshat 15-29 vjeç. Papunësia të këto grupmosha vlerësohet shumë më e lartë se ajo të grupmoshat 30 – 64 vjeç. Në vitin 2008 papunësia të grupmoshat 15-29 vjeç ishte 24.7% ndërsa të grupmoshat 30-64 vjeç ishte 10%. Ndërkohë që trendi i papunësisë të grupmoshat e rritura mbetet pothuajse i njëjtë, me luhatje të vogla, të grupmoshat e reja papunësia rritet dhe arrin maksimumin në vitin 2015 me 33.2%, ndërsa ulet në vijim duke arritur në vitin 2017 në 25.9%. Ndërkohë që në vitin 2017 papunësia të grupmoshat e rritura është 10.8%, duke treguar një hendek relativisht të lartë midis këtyre dy grupmoshave.


Grafiku 14: Shkalla e papunësisë sipas grupmoshës (%)



Burimi: INSTAT, 2018

Papunësia është një nga treguesit më thelbësorë të situatës së punësimit të një vendi. Në grafikonin e mëposhtëm paraqitet numri i të papunëve në çdo rajon të vendit për vitin 2017 të ndarë sipas gjinisë për të treguar edhe hendekun që ekziston ndërmjet tyre. Numri i të papunëve në nivel kombëtar për vitin 2017 arrin në 190 433, ku peshën më të lartë të tyre e përbëjnë ata në AZHR 2 me 42% të të papunëve në total, ndërsa më të ultën në AZHR 1 me 15% të totali të të papunëve. Ajo që vihet re është se në secili prej 4 rajoneve, meshkujt përbëjnë pjesën më të madhe të të papunëve në krahasim me femrat. Ky hendek vihet re veçanërisht në AZHR 1, ku kjo peshë arrin në 64%.

Grafiku 15: Papunësia sipas rajoneve dhe gjinisë, 2017




Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Numri i të punësuarve dhe i të papunëve nuk konsiderohen tregues të mirë të analizimit të tregut të punës për një vend, pasi janë tregues absolutë dhe nuk marrin parasysh numrin e popullsisë në moshë pune apo të pjesëmarrjes në forcën punëtore. Për këtë arsye, janë llogaritur shkalla e punësimit dhe ajo e papunësisë për secilin rajon, për të bërë të mundur krahasimin midis tyre, si dhe e ndarë sipas gjinive për të analizuar hendekun gjinor për këta dy tregues.

Më poshtë paraqitet shkalla e papunësisë për vitin 2017 për secilin rajon të vendit e ndarë për femrat dhe për meshkujt. Vihet re se në secilin prej rajoneve meshkujt duket se janë ata të cilët e kanë më të vështirë për të gjetur një punë në krahasim me femrat, veçanërisht hendeku është më i madh në AZHR 1, ku shkalla e papunësisë për meshkujt është 16%, ndërsa për femrat është 11%.

Grafiku 16: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe rajoneve, 2017



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve


Ndërsa në AZHR 3 dhe 4, hendeku është më i ulët, ku shkalla e papunësisë për meshkujt është vetëm 1% më e lartë se ajo e femrave. AZHR 4 renditet si rajoni i parë me shkallën më të lartë të papunësisë, konkretisht me 17%, me pas renditet AZHR 2 me 15%, AZHR 1 me 14% dhe e fundit AZHR 4 si rajoni ku të papunët duket se përbëjnë peshën më të ulët në raport me forcën e punës, me 10% në total.

Grafiku 17 dhe 18 paraqesin peshën e punësimit sipas sektorëve ekonomikë mesatarisht për dy periudha kohore: 2011-2013 dhe 2015-2017. Vihet re se në të dy periudhat mesatarisht, pesha e të punësuarve në sektorin e bujqësisë është ajo më e madhja, por vlen të theksohet se në periudhën e dytë kjo peshë ka rënë me mbi 13 pikë përqindje në krahasim me periudhën 2011-2013, konkretisht nga 45.9% pesha ka rënë në 39.9%. Megjithatë, sektori i bujqësisë ende punëson peshën më të madhe të të punësuarve shqiptarë.

Sektori i dytë më i madh për nga pesha e të punësuarve në Shqipëri renditet ai i shërbimeve të tregut, siç janë tregtia, transporti, hoteleria dhe shërbimet e biznesit dhe ato administrative. Pesha e punësimit në këtë sektor është rritur vit pas viti, ku mesatarisht për periudhën 2011-2013 llogaritet në 20.8%, ndërsa për atë 2015-2017 në 24.1%.

Sektori i shërbimeve jo të tregut duket se luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në punësimin e forcës së punës në Shqipëri, ku përfshihen shërbimet e administrimit publik, shërbimet sociale, shërbime dhe aktivitete të tjera. Punësimi në këtë sektor është rritur pothuajse në mënyrë të vazhdueshme, duke bërë që mesatarisht për periudhën 2011-2013 të zërë një peshë më të lartë në punësimin total se në atë 2015-2017, ku peshat llogariten në 15.8% dhe 16.9% përkatësisht. Vlen të theksohet se pesha e punësimit në sektorin e shërbimeve në total, pavarësisht nëse janë të tregut, apo jo, është rritur nga njëra periudhë në tjetrën, konkretisht me 12 pikë përqindje.

Grafiku 17: Punësimi sipas sektorëve ekonomikë për periudhën 2011-2013 (%)




Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Edhe punësimi në sektorin e prodhimit ka ardhur në rritje, por megjithatë, roli i këtij sektori në punësim nuk është aq i ndjeshëm sa sektorët e bujqësisë dhe shërbimeve, duke punësuar vetëm 7.2% të forcës së punës mesatarisht për periudhën 2011-2013 dhe 9.8% për atë 2015-2017. Pesha e punësimit në sektorin e ndërtimit ka pësuar luhatje të vazhdueshme duke filluar që nga vitit 2011, megjithatë për dy periudhat e marra në shqyrtim, kjo peshë ka rënë, duke shënuar 7.9% për periudhën 2011-2013 dhe 6.8% për periudhën 2015-2017 mesatarisht. Sektori i industrive të

tjera, siç janë ato nxjerrëse, të energjisë, gazit dhe furnizimit me ujë, duket se kanë luajtur rolin më të vogël në punësim përgjatë të dyja periudhave, ku mesatarisht për dy periudhat e marra në shqyrtim punësimi në këtë sektor llogaritet në 2.3% dhe 2.5% përkatësisht, duke mos shënuar ndryshim të konsiderueshëm nga njëra te tjetra.


Grafiku 18: Punësimi sipas sektorëve ekonomikë për periudhën 2015-2017 (%)



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Nëse bëjmë një ndarje të numrit të të punësuarve për çdo rajon sipas sektorit ekonomik në të cilin ata janë punësuar, vëmë re që në tri prej katër rajoneve, sektori i bujqësisë punëson pjesën më të madhe të individëve, me përjashtim të AZHR 2, ku mbizotëron punësimi në sektorin e shërbimeve me mbi 58% të të punësuarve dhe më pas punësimi në sektorin e industrisë me mbi 26% të të punësuarve.

Grafiku 19: Punësimi sipas rajoneve dhe sektorit ekonomik, 2017



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve


Numri më i madh i të punësuarve në sektorin e bujqësisë i përket AZHR 3, duke përbërë edhe 39% të të punësuarve total në këtë sektor. Përsa i përket sektorit të industrisë, vihet re se vetëm në rajonin e dytë ai përbën një pjesë të konsiderueshme të të të punësuarve, ndërkohë që në tri rajonet e tjera kjo peshë është relativisht e ulët, duke filluar nga 12% në AZHR 3 e deri në 18%

në AZHR 1. Këto shifra tregojnë për natyrën kryesisht bujqësore të punësimit në tri prej rajoneve të vendit, dhe mbizotërimin e punësimit në sektorin e shërbimeve në rajonin e dytë, e kryesisht në kryeqytet.

Në grafikun 20 paraqitet numri i të punësuarve në sektorin privat jo-bujqësor në Shqipëri, të ndarë sipas 4 rajoneve gjatë periudhës 2012 – 2016. Sikurse mund të vihet re, numri i të punësuarve ka ardhur në rritje vit pas viti, veçanërisht për AZHR 2. Kjo AZHR përbën edhe peshën më të madhe të numrit të të punësuarve gjatë gjithë kësaj periudhe. Në vitin 2016, të punësuarit në sektorin privat jo-bujqësor në AZHR 2 zinin rreth 64% të totalit të të punësuarve të këtij sektori, ndërsa në vitin 2016 kjo peshë është rritur në 69%, duke numëruar gati 285 mijë të punësuar.

Kjo shifër e lartë shkaktohet për shkak të përqendrimit të të punësuarve në Qarkun e Tiranës, i cili punëson çdo vit mbi 50% të totalit të punësuarve në sektorin privat jo-bujqësor. Vlen të theksohet se numri i të punësuarve ka ardhur në rritje edhe për AZHR-të e tjera, pavarësisht se ato punësojnë në një masë më të ulët se AZHR 2.

Grafiku 20: Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor




Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Analiza e trendit të punëkërkuesve të regjistruar është bërë jo vetëm sipas gjinisë, grupmoshave dhe nivelit arsimor, por edhe në raport me popullsinë në moshë pune. Në grafikët e mëposhtëm paraqitet ecuria e punëkërkuesve dhe popullsisë në moshë pune të ndarë respektivisht për tri grupmosha.

Vihet re që popullsia e grupmoshës 15-19 vjeç ka pësuar trend rënës me kalimin e kohës, por me ritme më të ulëta se rënia e punëkërkuesve. Koncretisht në vitin 2017 popullsia e kësaj grupmoshe arrin në 2.178 milionë banorë, ndërsa punëkërkues të regjistruar numërohen në 2,096 mijë banorë. Ulja e numrit të punëkërkuesve të kësaj grupmoshe me kalimin e viteve mund të shpjegohet me përfshirjen gjithnjë e më të madhe të të rinjve në sistemin arsimor.


Grafiku 21: Numri i punëkërkuessve dhe popullsia në moshë pune (15-19 vjeç), 2001-2017



Burimi: INSTAT, 2018

Vihet re që popullsia e grupmoshës 20-34 vjeç ka pësuar ndryshim në trend gjatë periudhës 2001-2017. Gjatë viteve 2001-2009 trendi i popullsisë së kësaj grupmoshe ka qenë rënës, ndërsa periudha e mëvonshme shënon një kthesë në ecurinë e popullsisë për grupmoshën 20-34 vjeç, duke arritur në rreth 675 mijë banorë. Nga ana tjetër vihet re që punëkërkuessit kanë pësuar një trend rënës pothuajse gjatë gjithë periudhës së marrë në shqyrtim, gjë që tregon se popullsia në moshë punë nuk ka ecur në të njëjtin trend me punëkërkuessit për grupmoshën 20-34 vjeç me kalimin e kohës.


Grafiku 22: Numri i punëkërkuessve dhe popullsia në moshë pune (20-34 vjeç), 2001-2017



Burimi: INSTAT, 2018

Përsa i përket popullsisë së grupmoshës 35-64 vjeç, vihet re që ajo ka pësuar trend rritës me kalimin e viteve, duke arritur 1.082 milionë banorë në vitin 2017. Nga ana tjetër vihet re që punëkërkesit kanë pësuar një trend pothuajse konstant përgjatë periudhës 2001-2015, ndërsa për dy vitet e fundit vihet re një rënie e ndjeshme e numrit të punëkërkesve të kësaj grupmoshe, duke arritur në 64.5 mijë punëkërkes në vitin 2017.


Grafiku 23: Numri i punëkërkesve dhe popullsia në moshë pune (35-64 vjeç), 2001-2017



Burimi: INSTAT, 2018

Përsa i përket karakteristikave të punëkërkesve, më poshtë paraqiten ndarjet e peshës së punëkërkesve sipas gjinisë, grupmoshave dhe nivelit arsimor për periudhën 2000-2017. Nga grafiku 24 vihet re se pesha e punëkërkesve meshkuj ndaj totalit të punëkërkesve është gati e njëjtë me atë të femrave dhe vihen re ndryshime shumë të vogla përgjatë viteve.

Grafiku 24: Peshja e punëkërkesve sipas gjinisë dhe numri i tyre




Burimi: INSTAT, 2018

Para vitit 2009, më tepër të regjistruar si të papunë ishin meshkujt, por pas këtij viti situata përmbyset duke bërë që pesha e femrave punëkërkuese të jetë më e lartë se ajo e meshkujve për çdo vit pasues. Në vitin 2017 shënohet hendeku më i madh ndërmjet dy gjinive, ku pesha e punëkërkueseve femra arrin në 53%, ndërsa ajo e meshkujve në 47%. Kjo situatë krahasuar në nivel kohor është e anasjellta me atë të vitit 2000 ku kishim 53% punëkërkuës meshkuj kundrejt 47% punëkërkuës femra, ndërkohë krahasuar me 10 vjet më parë, pra në vitin 2008 kishte një dominim të vogël të punëkërkueseve meshkuj. Ky trend tregon rritjen e interesit të femrave për tu bërë pjesë aktive e tregut të punës gjë e cila duhet parë si faktor pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm por nga ana tjetër edhe si një faktor shtytës për të ndërmarrë politika në nivel gjithëpërfshirës.

Siç mund të shihet dhe nga grafiku 25, pesha e punëkërkueseve të papunë të grupmoshës 20-34 vjeç ndaj totalit të punëkërkueseve ka ardhur në rënie, ndërkohë që pesha e atyre të grupmoshës mbi 35 vjeç ka pësuar një tendencë rritjeje, duke thelluar gjithnjë e më tepër hendekun ndërmjet këtyre dy grupmoshave.

Grafiku 25: Pesha e punëkërkueseve sipas grupmoshës



Burimi: INSTAT, 2018


Vihet re se për dy vitet e fundit këto tendenca kanë qenë më të theksuara, ku pesha e punëkërkueseve të grupmoshës 20-34 vjeç ka rënë me 8.8 pikë përqindje dhe 16.1 pikë përqindje gjatë viteve 2016 dhe 2017, ndërsa ajo e grupmoshës mbi 35 vjeç është rritur me 6.1 pikë përqindje dhe 9.7 pikë përqindje gjatë dy viteve të fundit përkatësisht. Mund të thuhet se tregu i punës për 2016 përkrah më tepër të rinjtë, moshat 20-34 vjeç, të cilët e kanë më të lehtë gjetjen e një pune se personat mbi 35 vjeç.

Përsa i përket grupmoshës 16-19 vjeç, pesha e punëkërkueseve paraqitet relativisht e ulët dhe me një tendencë rënëse, ku në vitin 2000 kishte një nivel prej 12% ndërsa në vitin 2017 një nivel prej 2 %, një trend i cili ka rëndë dukshëm me kalimin e kohës.

Me interes është fakti i analizës së nivelit të punëkërkesve gjatë viteve 2016 dhe 2017, ku vihet re një reduktim i konsiderueshëm i numrit të punëkërkesve, ku nëse krahasojmë vitin 2017 me vitin 2015 ky nivel arrin në rreth 40% rënie. Kjo rënie ka ardhur pikërisht nga grupmoshat 16-19 vjeç dhe 20-34 vjeç, pra nga grupmoshat e reja të tregut të punës.

Konsideruar ndarjen sipas nivelit arsimor, rezultojnë se pesha e punëkërkesve ndahet pothuajse e gjithë ndërmjet atyre me arsim 8-9 vjeçar dhe atyre me arsim të mesëm. Megjithatë, pavarësisht peshës konstante në 2% nga viti 2001 deri në 2007, vihet re një tendencë rritëse pas këtij viti e peshës së punëkërkesve me arsim të lartë, ku në vitin 2015 kjo peshë arrin vlerën më të lartë me 8%. Gjatë dy viteve të fundit, situata duket se është përmirësuar, por gjithsesi punëkërkesit me arsim të lartë përbëjnë 6% të totalit të punëkërkesve.

Grafiku 26: Pesha e punëkërkesve sipas nivelit arsimor



Burimi: INSTAT, 2018

Punëkërkesit me arsim 8-9 vjeçar janë ata që hasin më shumë vështirësi në gjetjen e një pune. Gjatë dy viteve të fundit pesha e tyre ka pësuar rritje, duke arritur vlerën më të lartë të periudhës në 2017 me 56% të totalit të punëkërkesve. Në vitin 2000 numri i punëkërkesve me arsim 8/9 vjeçar ka qenë 104,604, duke zënë një peshë prej 48.6%, ndërsa në vitin 2017 numëroheshin 50250 punëkërkes me arsim 8-9 vjeçar. Përsa i përket punëkërkesve me arsim të mesëm, rezultojnë se jo vetëm numri, por edhe pesha e tyre ka pësuar një tendencë zbritëse përgjatë viteve, duke treguar për rolin më të madh që ka marrë përbushja e shkollës së mesme në gjetjen e një pune.

Shqetësues është fakti që punëkërkesit me arsim të lartë janë rritur gjatë tre viteve të fundit. Ky mund të jetë një mesazh i fortë në kushtet kur jemi në situatë kur kemi reduktim të papunësisë dhe nga ana tjetër rritje të punëkërkesve me arsim të lartë. Pra kjo mund të jetë një shenjë e mospërputhjes mes kërkesës dhe ofertës për kapitalin human të mirëarsimuar, gjë e cila kërkon

ndërmarrjen e reformave strukturore të arsimit të lartë për të fokusuar nivelin e tretë të edukimit drejt profileve me interes të tregut.

2.2. Tregu i Punës dhe Arsimi

Tranzicioni nga institucionet arsimore në tregun e punës është një ndër vështirësitë kryesore të të rinjve dhe një ndër shkaqet e papunësisë të rinjtë. Shpesh ky tranzicion shoqërohet edhe me probleme, pasi sa më e gjatë koha e pritjes për punë mbas diplomimit aq më shumë ulet motivimi i tyre për të qenë konkurrues në treg. Gjithashtu, një tranzicion i gjatë është një dëmtim i kapitalit human të akumuluar përgjatë viteve të shkollimit dhe në raste të tjera, kur për shkak të rrethanave pranohen punë në profesione të tjera, dëmtimi është edhe më i madh. Trajnimi dhe ritrajnimi në përputhje me tregjet e punësimit mbetet investimi më i mirë individual dhe i qeverisë në objektivat e saj për rritjen e punësimit.

Për këto arsye, një periudhë më e shkurtër tranzicioni nga shkolla në pune është produktive pasi përfshin në tregun e punës më shpejt dhe më shumë të mirëarsimuar sipas profesioneve të tyre. Një treg pune që funksionon mire është ai që absorbon shumicën e të sapo diplomuarve brenda pak muajsh nga përfundimit i shkollimit të tyre. Në këtë moment, të rinjtë fillojnë karrierën e tyre si të rritur pas shumë viteve të arsimimit formal.

Sipas raportit të Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (2015) mbi trendet e punësimit rinor në Shqipëri, gjetja e punës së parë kurrë nuk ka qenë një proces i lehtë në një treg pune jo të kontrolluar nga shteti (që është rasti i Shqipërisë pas 1990).⁸ Aktualisht ky hap po bëhet një sfidë e vështirë dhe mund të kthehet në një rrugë të gjatë. Për më tepër, kriza e zgjatur e punësimit në vend detyron të rinjtë jo vetëm të presin më gjatë për punën e tyre të parë, por edhe për të qenë më pak selektiv për llojin e punëve të para që ata janë duke kërkuar dhe duke pranuar.

Këtij faktori i shtohet edhe mos familjarizimi i prindërve apo të rriturve me modelin e tregut konkurrues të punës. Shumica e tyre kanë filluar punë pas viteve '90, kur sektori privat sapo kishte filluar dhe pjesa më e madhe e vendeve të punës ofrohej ende nga sektori publik. Si e tillë rruga e tyre profesionale ndërtohej nga shteti dhe madje edhe në qoftë se nuk ishte ajo e dëshiruara, të paktën nuk ishte e pasigurt. Sot, të kuptuarit dhe të pranuarit e pasigurisë në karrierën e fëmijëve të tyre, duhet ti shtohet dhe kompleksiteti i sektorëve dhe profesioneve të reja, kompleksiteti i mekanizmeve ekzistues të tregut të punës në krahasim me një sistem të centralizuar dhe të organizuar, shumëfishimi i diplomave dhe kualifikimeve, dhe rruga jo-tradicionale e profesioneve të të rinjve në sistemin post-modern ekonomik të sotëm.⁹

Sipas Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (2014-2020), problemi i tranzicionit nga shkolla në punë është i pranishëm në një masë të madhe, si në institucionet private ashtu edhe në ato publike të arsimit. Aktorët e Agjencisë së Formimit Profesional (AFP) kanë të njëjtin qëndrim përsa i përket përparimit të bërë deri tani në këtë fushë. Ata e pranojnë se tashmë

⁸ <http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2015/10/t-150427-text-al.pdfs>

⁹ Shtetiweb.org dhe Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (2015). *Trendet e Punësimit Rinor në Shqipëri: Çfarë Kërkon Tregu?*. [online] Tiranë: Friedrich-Ebert-Stiftung. E aksesueshme: <http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2015/10/t-150427-text-al.pdf> [Accessed 28 Jul. 2017].

ekzistojnë disa raste të praktikës së mirë të bashkëpunimit të institucioneve të arsimit me tregun e punës, por pavarësisht kësaj, sistemi i AFP-së përballet me një numër mangësish. Sistemi i AFP-s duhet të jetë më i orientuar drejt kërkesës së tregut të punës. Është e domosdoshme të ndërmerret një analizë sistematike e tregut të punës për të vlerësuar se cilat janë kualifikimet e kërkuara dhe se si mund të bëhet përshtatja dhe planifikimi i kurseve në të ardhmen.

Shumë pak biznese bashkëpunojnë me shkollat për organizimin e orëve të praktikës për nxënësit. Në pothuajse të gjitha rastet bizneset që bashkëpunojnë kanë qenë biznese të zhvilluara në mënyrë modeste përsa i përket madhësisë dhe teknologjisë. Motivimi i tyre i vetëm për të bashkëpunuar ishte i lidhur me kontaktet e tyre personale me drejtorët e shkollave. Në të gjitha rastet drejtorët e shkollave pohojnë se bordet janë thjesht organe shumë formale, duke pasur parasysh mënyrën se si janë krijuar dhe se si e ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Këto borde përfshijnë edhe përfaqësues nga biznesi, të cilët nuk luajnë ndonjë rol të rëndësishëm në proceset e vendimmarrjes dhe aq më pak të ndihmojnë në lehtësimin e praktikave apo punësimit.¹⁰

Tranzicionin e të rinjve në tregun e punës, në një farë mënyre e pengon edhe mungesa e koordinimit midis institucioneve të arsimit dhe bizneseve. Nëse të rinjtë janë të motivuar të hyjnë në tregun e punës, duhet patjetër dhe një nyje lidhëse apo një shtytje në formën e informacionit për ta bërë këtë proces sa më të shkurtër. Mungesa e koordinimit sjell shpesh mungesën e praktikave, të cilat sjellin mungesën e eksperiencës dhe më pas edhe një periudhë të gjatë tranzicioni.

Një studim i rëndësishëm mbi tranzicionin e të rinjve në punë dhe lidhjen me aftësitë e marra në universitet është kryer nga Kruja (2016) për mbi 331 studentë të cilët kishin mbaruar universitetin pesë vitet e fundit nga të cilët mbi tre të katërtat e tyre deklaruan se ishin të punësuar me kohë të plotë, një pjesë e vogël të punësuar me kohë të pjesshme dhe 19.8% e tyre ishin të papunë. Studimi fokusohet te dobia e aftësive të marra gjatë viteve të studimit në universitet dhe kohëzgjatja e punësimit nga periudha e diplomimit, si dhe vështirësitë e hasura gjatë procesit të kërkimit të punës. Ky studim solli një sërë gjetjesh të cilat konfirmojnë edhe më tej qëndrimet e mësipërme. Disa nga këto gjetje janë:

- Për personat e punësuar (me kohë të plotë ose të pjesshme), më pak se gjysma e tyre u përgjigj se puna që po kryenin ishte e lidhur direkt me arsimin e marrë përgjatë universitetit, ndërsa për pjesën tjetër kjo lidhje nuk është e plotë ose nuk ka asnjë lidhje me arsimin e kryer.
- Papunësia ka lidhje me kërkimin e një punë në profesionin e tyre. Nga ish – studentët e anketuar, që rezultojnë të papunë, gati gjysma e tyre kanë deklaruar se janë duke kërkuar një pozicion pune që lidhet me arsimin e tyre. Edhe të papunët për shkak të mos gjetjes së një pune të përshtatshme duket se zënë një peshë të konsiderueshme. Kjo tregon se për papunësinë e të rinjve të diplomuar një nga shkaqet kryesore është edhe mungesa e

¹⁰ Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (2014). *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020*. Tiranë. E aksesueshme: http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Strategjia_per_Punesim_dhe_Aftesim_2014-2020.pdf


vendeve të punës në profesionin e tyre, ose në një farë mënyre një mbingopje e tregut me të diplomuar.

- Shumica e ish – studentëve të anketuar kanë deklaruar se në periudhën e diplomimit kishin gjetur punën e tyre të parë, ndërsa shumica e pjesës tjetër kanë dashur më pak se një vit për ta gjetur një të tillë. Një pjesë relativisht e vogël e tyre kanë rezultuar ende të papunë në kohën e anketimit. Megjithatë duket se të anketuarit të cilët vazhdojnë të kenë sukses në mbajtjen e një punë janë ata të cilët kanë pasur një punë në momentin e diplomimit ose një kohë të shkurtër më vonë, duke sugjeruar se koha e tranzicionit nga shkolla në punë duhet të jetë sa më e shkurtër.

2.3. Tregu i punës dhe madhësia e ndërmarrjeve

Duke analizuar më tej sektorin privat, mund të krijojmë një panoramë të ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe shpërndarjes së të punësuarve në to. INSTAT mundëson të dhëna vjetore për ndërmarrjet sipas numrit të të punësuarve për periudhën 2012-2016. Janë kategorizuar ndërmarrjet sipas madhësisë duke përdorur numrin e të punësuarve në ato me 1 – 9 punonjës; 10 – 49 punonjës; 50 – 249 punonjës; mbi 250 punonjës.

Grafiku 27: Punësimi sipas madhësisë së ndërmarrjeve




Burimi: INSTAT, 2017

Në 2012 tregu i punës ndahej midis ndërmarrjeve mikro me 1 – 9 punonjës, të cilat kishin 44.7% të të punësuarve, ndërmarrjeve të vogla me 10 – 49 punonjës, të cilat kishin 19.3% të të punësuarve, ndërmarrjeve të mesme me 50 – 249 të punësuar, të cilit punësonin 17.7% dhe ndërmarrjeve të mëdha me mbi 250 punonjës, që punësonin 18.3% të totalit të të punësuarve. Ajo që vihet re është se ndërmarrjet mikro dhe ato vogla kanë punësuar pothuajse gjithnjë e më pak individë në terma relativë me kalimin e viteve, ndërsa ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha kanë pësuar rritje në peshën e të punësuarve. Në 2016 ndërmarrjet mikro dhe ato të vogla punësonin në total 60% të të punësuarve, ndërsa ato të mesme dhe të mëdha 40% të tyre, duke

treguar që këto ndërmarrje kanë më tepër ndikim në punësimin e popullsisë në krahasim me disa vite më parë.

Në fund të vitit 2017, pesha e ndërmarrjeve mikro që punësojnë 1 – 9 punonjës zinte 94.9% të totalit të ndërmarrjeve. Pesha e ndërmarrjeve të vogla që punësojnë 10 – 49 punonjës kap vlerën e 4.1%. Ndërkohë, ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha përbëjnë vetëm 1% të totalit të ndërmarrjeve, duke numëruar 1148 të tilla. Këto shifra tregojnë për strukturën e ndërmarrjeve në Shqipëri të përqendruara pothuajse tërësisht në ndërmarrje mikro dhe të vogla e të mesme. Duke konsideruar peshën e lartë të punonjësve që punësojnë ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, rezulton se pavarësisht numrit shumë të ulët të tyre, ato luajnë një rol të konsiderueshëm në sigurimin e vendeve të punës për tregun e punës në Shqipëri, duke punësuar 60% dhe 40% të të punësuarve konkretisht.

Grafiku 28: Pesha e ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve, 2017



Burimi: INSTAT, 2018

Për të bërë të mundur një pasqyrim të numrit të ndërmarrjeve të kategorizuar sipas numrit të punonjësve dhe numrit të të punësuarve në total të tyre, është ndërtuar tabela përmbledhëse e mëposhtme për vitin 2016. Ajo që vihet re më së shumti është se numri total i të punësuarve është i ndarë në mënyrë pothuajse të barabartë ndërmjet ndërmarrjeve me 1-9 punonjës që punësojnë 41.3% të tyre për vitin 2016 dhe atyre me mbi 50 punonjës që punësojnë 40% për këtë vit. Por nga ana tjetër, numri i ndërmarrjeve të vogla përbëjnë mbi 95% të totalit të ndërmarrjeve në Shqipëri, ndërsa ndërmarrjet me 50 punonjës përbëjnë vetëm 1.1% të totalit. Pra, pavarësisht hendekut shumë të madh në numër ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, hendeku në numrin e individëve që ato punësojnë është pothuajse inekzistent. Kjo tregon për kontributin e madh që japin kompanitë e mëdha në tregun e punës shqiptar.

Tabela 1: Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë

	Numri i ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve
1 – 9 punonjës	95.2%	41.3%
10 – 49 punonjës	3.7%	18.7%
+ 50 punonjës	1.1%	40%

Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

INSTAT mundëson të dhëna vjetore për numrin e ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve dhe sipas aktivitetit ekonomik që ato kryejnë. Këto ndërmarrje kategorizohen në 4 lloje sipas numrit të të punësuarve, konkretisht me 1 – 4 punonjës; 5 – 9 punonjës; 10 – 49 punonjës; mbi 50 punonjës. Në grafikun 29 paraqitet pesha e ndërmarrjeve të ndara në varësi të numrit të të punësuarve dhe aktivitetit ekonomik të tyre për vitin 2017.

Nga grafiku 29 dallohet qartë se peshën më të madhe të ndërmarrjeve për çdo aktivitet e zënë ato me 1-4 punonjës, veçanërisht në aktivitetin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, ku kjo peshë kap vlerën 99.6%. Kjo tregon për madhësinë e vogël të pjesës dërrmuese të fermave bujqësore apo ndërmarrjeve të tjera të këtij sektori, të cilat janë të organizuara kryesisht në njësi familjare.

Kutia 2:


Trajnimi i fermerëve në teknikat më të mira bujqësore ka treguar që rritet produktiviteti i fermerëve. Disa projekte zgjerojnë programet e trajnimit ose bashkëpunimin për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit. Herë pas here, kjo është kombinuar me rritjen e aksesit në financa ose inputet e kërkuara për bujqësinë si një shtysë për përmirësimin e produktivitetit bujqësor. Krijimi i kooperativave përmirëson lidhjet midis agrobizneseve përgjatë zinxhirit të vlerës.¹

Referenca:

¹ <https://elibrary.worldbank.org/doi/pdf/10.1596/978-1-4648-1328-3?download=true>

Numri i ndërmarrjeve të aktivitetit të ndërtimit dhe industrisë me numër punonjësish 5-9 dhe me 10-49 është më i madh krahasuar me aktivitetet e tjera, me pesha 27.6% dhe 20.9%. Edhe numri i ndërmarrjeve me mbi 50 punonjës u përket këtyre aktivitetëve. Informacioni dhe komunikacioni, si dhe shërbimet e tjera llogarisin gjithashtu numër të lartë ndërmarrjesh me mbi 50 punonjës, konkretisht llogariten 41 të tilla për informacionin dhe komunikacionin dhe 777 për shërbimet e tjera.

Grafiku 29: Pësja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik, 2017



Burimi: INSTAT, 2018

Studimi i panoramës së ndërmarrjeve, si për shembull lloji i tyre apo numri i individëve që ato punësojnë, është një çështje me rëndësi në studimin e tregut të punës. Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim CDI, në studimin e tij ‘‘Trendet e punësimit rinor në Shqipëri. Çfarë kërkon tregu?’’, në prill të 2015, ka anketuar një kampion prej 800 kompanish nga mbi 1200 që janë të regjistruara në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, të ponderuara sipas aktivitetit ekonomik dhe shpërndarjes gjeografike për të përfaqësuar tendencën e punësimit të të rinjve në nivel kombëtar, si dhe për të identifikuar profilin më të kërkuar të punonjësit të ri.¹¹

Nga anketimi ka rezultuar se punonjësve në më shumë se gjysmën e ndërmarrjeve iu nevojiten deri në 3 muaj kohë për të fituar aftësitë e nevojshme, ndërsa vetëm në një pjesë të vogël të ndërmarrjeve, atyre u duhet një vit kohë që të fitojnë aftësitë e nevojshme. Kjo tregon për nivelin relativisht të ulët të vështirësisë dhe vlerës së shtuar në ofertën e të sapo punësuarve.

Më shumë se gjysma e ndërmarrjeve të anketuara janë shprehur se punonjësve të tyre iu mjafton vetëm arsimi i mesëm, ndërsa pësja e ndërmarrjeve që kanë nevojë për punonjës me arsim të lartë universitar dhe e atyre për të cilat nuk ka rëndësi niveli arsimor i të punësuarve, rezultojnë në nivele të përafërta. Konsideruar periudhën e shkurtër kohore për të cilën një punonjës mesatarisht fiton aftësitë e nevojshme për të punuar dhe nivelin e nevojshëm të arsimit, mund të thuhet se një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve që operojnë në tregun shqiptar kryejnë veprimtari që kanë nevojë për nivel të ulët të kapitalit human, gjë që përkthehet në produktivitet të ulët të tyre.

Më shumë se gjysma e ndërmarrjeve të anketuara nuk përmendin asnjë kosto për procedurën e pushimit të punonjësve të rinj nga puna, ndërsa përqindje të vogla të tyre përmendin kosto financiare, ligjore e në kohë. Kjo tregon për fleksibilitetin e punonjësve për tu larguar nga një punë me kosto të ulëta.

¹¹Instituti për Kërkim dhe Zhvillim CDI (2015): ‘‘Trendet e Punësimit rinor në Shqipëri, Çfarë kërkon tregu?’’.Tiranë. E aksesueshme:<http://cdinstitute.eu/ëeb/ëp-content/uploads/2015/10/t-150427-text-al.pdf>

Për procedurën e publikimit të vendeve të lira të punës, më shumë se gjysma e kompanive deklarojnë se përdorin lidhje familjare dhe miqësore. Në numër më të ulët renditen ato që përdorin Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe gazetat dhe e-median, ndërsa në numër akoma më të ulët renditen ato që përdorin kompanitë private të rekrutimit apo forma të tjera. Në këtë kuadër del si domosdoshmëri që të krijohen mundësi alternative për gjetjen e krahut të punës.

2.4. Tregu i punës dhe niveli i Pagave

Në tabelën 2 paraqiten diferencat e pagës mujore bruto për një të punësuar ndërmjet meshkujve dhe femrave për vitet 2016-2017 sipas aktiviteteve ekonomike. Vihet re që për të dy vitet meshkujt paguhen mesatarisht më shumë se femrat, por ky hendek është zbutur në vitin 2017 në krahasim me vitin paraprak, duke kaluar nga 11.4% në 10.5% për ekonominë në tërësi.

Vlen të theksohet se paga mesatare e meshkujve është mesatarisht më e lartë se ajo e femrave për të gjithë aktivitetet ekonomike, me përjashtim të atij të arteve, argëtimit dhe çlodhjes, aktiviteteve të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbimeve të tjera. Megjithatë, edhe për këtë aktivitet, hendeku ndërmjet dy gjinive ka rënë nga viti 2016 në vitin 2017, duke arritur në 9.3%.

Bazuar mbi këto të dhëna, mund të thuhet se femrat janë ato të cilat e vuajnë më tepër fenomenin e diskriminimit gjinor në paga dhe se duhet të mbetet një sfidë për tregun e punës në Shqipëri zbutja dhe eliminimi i këtij fenomeni, si një ha më përpara drejt një tregu të drejtë punësimi për të gjithë.

Tabela 2: Hendeku gjinor i pagës mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve ekonomike

Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev2	2016	2017
Gjithsej	11.4%	10.5%
Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim	3.3%	7.7%
Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit	37.8%	35.3%
Ndërtimi	12.5%	14.0%
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	12.8%	10.6%
Informacioni dhe komunikacioni	13.9%	14.7%
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	15.8%	17.8%
Aktivitete të pasurive të paluajtshme; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	7.4%	5.6%
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimit; shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	14.3%	13.7%
Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera	-16.1%	-9.3%

Burimi: INSTAT, 2018

INSTAT mundëson gjithashtu të dhëna mbi diferencat gjinore në paga sipas grup-profesioneve. Ajo që vihet re nga tabela është se femrat paguhen më shumë se meshkujt vetëm në grup-profesionin e nëpunësve, hendek i cili është ulur me 69 pikë përqindje nga viti 2016 në 2017, si

dhe për grup-profesionin e forcave të armatosura, por kjo vetëm për vitin 2016. Në vitin 2017 ka pasur barazi gjinore në paga për këtë grup-profesion.

Grup-profesionet me hendekun më të madh gjinor në paga janë ato të punonjësve të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve, si dhe të zejtarëve, artizanëve dhe profesioneve të lidhura me to. Për më tepër, ky hendek gjinor ka ardhur në rritje për vitin 2017, duke kapur norma relativisht të larta, 29.1% dhe 27.9% përkatësisht.

Pas grup-profesionit të forcave të armatosura, ai i ligjvënësve, nëpunësve të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorëve ekzekutivë, ka hendekun më të ulët gjinor në paga. Në vitin 2017 ky hendek është zbutur akoma më shumë, duke arritur në vetëm 0.2%.

Tabela 3: Hendeku gjinor i pagës mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve

Grup-profesionet sipas ISCO-08	2016	2017
Gjithsej	11.4%	10.5%
Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	3.1%	0.2%
Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	24.8%	22.8%
Teknikë dhe specialistë në zbatim	12.4%	10.8%
Nëpunësit	-4.5%	-1.4%
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	22.0%	20.4%
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit	6.3%	7.1%
Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to	26.5%	27.9%
Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	28.5%	29.1%
Punëtorë (Profesione elementare)	7.5%	7.1%
Forcat e armatosura	-0.3%	0.0%

Burimi: INSTAT, 2018

2.5. Tregu i Punës dhe Grupet e Pafavorizuara

Sipas Bankës Botërore një grup i pafavorizuar është një popullsi me karakteristika specifike të cilat krijojnë një risk të lart për të qenë të varfër, duke përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe fëmijët, ish ushtarakët apo emigrantët e kthyer, individët e infektuar me HIV/AIDS, minoritetet fetare dhe etnike dhe në disa shoqëri edhe gratë. Ndërkohë në projekt-ligjin për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë grupet e pafavorizuara përcaktohen si grupet me problem të varfërisë ekstreme, përjashtimit social për shkak të diskriminimit, papunësisë afatgjatë, vështirësive për shkak të të qenit i proceduar penalisht apo nën varësinë e drogës dhe alkoolit dhe personat e shpërngulur.

Ndërmarrje Sociale (NS) janë subjekte që krijojnë mundësi punësimi për grupet e pafavorizuara. Në një studim të kryer nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, "Sfidat dhe mundësitë për punësimin e grupeve të marginalizuara nga ndërmarrjet sociale" të vitit 2016, janë gjetur 35 ndërmarrje sociale nga kampionimi i zhvilluar dhe janë futur në studim 30 prej tyre.¹²

¹²Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (2016): "Sfidat dhe mundësitë për punësimin e grupeve të marginalizuara nga ndërmarrjet sociale". Tiranë. E aksesueshme: <http://partnersalbania.org/News/konferenca-sfidat-dhe-mundesite-per-punesimin-e-grupeve-te-margjinalizuara-nga-ndermarrjet-sociale/>

Gjetjet treguan se NS-të janë themeluar më së shumti vitet e fundit, dhe sipas të dhënave të studimit të vitit 2015 rezultoi se vetëm gjatë 2009-2014 janë ndërtuar më shumë se gjysma e tyre. Kjo tregon për rëndësinë në rritje që u është kushtuar punësimit të grupeve të pafavorizuara.

Gati gjysma e NS-ve të marra në studim janë Organizata Jo Fitimprurëse, ndërsa në numër më të ulët dhe gati të barabartë renditen Personat Fizikë dhe Shoqëritë Kursim Krediti. Shoqëritë e Bashkëpunimi Reciprok përbëjnë një pjesë të vogël të NS-ve.

Pjesa më e madhe e NS-ve deklaroi një numër të ulët punonjësish, ku 70% e tyre deklaroi se kanë nga 0-5 punonjës me kohë të plotë dhe nga 0-5 me kohë të pjesshme. Vetëm 3% e tyre deklaroi se kanë nga 16-20 punonjës dhe nga 21-25 punonjës me kohë të plotë dhe mbi 100 punonjës me kohë të pjesshme. Këto të dhëna tregojnë se, pavarësisht se numri i NS-ve ka ardhur në rritje vitet e fundit, ato nuk garantojnë punësim për një pjesë të madhe të grupeve të pafavorizuara.

Përsa i përket burimit të të ardhurave të NS-ve, pjesa më e madhe e atyre që janë marrë në studim kanë rezultuar se i sigurojnë të ardhurat nga shitja të konsumatorëve publikë apo privatë dhe një pjesë akoma më e vogël e tyre i sigurojnë nga burime filantropike. NS-të që i sigurojnë të ardhurat e aktivitetit të tyre nga grantet, investimet, apo nga pagesat e anëtarësisë rezultojnë të jenë të pakta në numër. Kjo tregon për vështirësitë financiare me të cilat përballen NS-të në Shqipëri dhe që mund të përkthehet në një tregues se pse shumica e tyre punësojnë një numër të vogël personash.

2.6. Tregu i punës dhe ri-integrimi i emigrantëve të kthyer në vend

Një ndër pasojat më të rëndësishme për ekonominë shqiptare të ndodhura si pasojë e rënies së regjimit komunist në Shqipëri ishte emigrimi masiv i shqiptarëve, kryesisht në vendet fqinje si Greqia, Italia dhe vendet e tjera të Evropës Perëndimore. Megjithatë, vitet e fundit, veçanërisht pas krizës financiare të vitit 2008, situata e vështirë ekonomike e këtyre vendeve pritëse të emigrantëve shqiptarë, bëri që një pjesë e madhe e tyre të kthehen sërish në vend.

Emigrantët e kthyer kërkonin që të ripërfshiheshin ose të ritrupëzoheshin në tregun e punës shqiptar, thënë ndryshe të ri-integroheshin në këtë treg duke ndryshuar edhe strukturat e tij. Ri-integrimi në tregun shqiptar të punës duket se ka qenë edhe një nga arsyt kryesore të kthimit të tyre në vendin e origjinës, pasi shumica e të kthyerve ishin të papunë. Sipas një raporti të INSTAT dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin, "*Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi*" të vitit 2013, rezultoi se 63.2% janë kthyer në Shqipëri për shkak të humbjes së punës në vendin e imigracionit dhe 16.5% e tyre për shkak të humbjes së kontratës së punës në këtë vend. Duke përfshirë edhe ata që nuk kanë mundur të jenë pjesë e tregjeve të punës në vendet pritëse, rezultoi se mbi 80% e të kthyerve kanë qenë për shkak të pamundësisë së integrimit të mëtjetshëm në tregjet e punës në vendet e imigracionit.¹³

¹³INSTAT dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2013): "*Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi*". Tiranë. E aksesueshme: http://www.instat.gov.al/media/255790/migracioni_i_kthimit_dhe_ri-integrimi_2013_.pdf

Tabela e mëposhtme, e cila paraqet aktivitetet kryesore ku janë integruar të kthyerit nga emigracioni, tregon se në Shqipëri, në periudhën 2009 -2013, janë kthyer gjithsej 133,544 shtetas shqiptarë të moshës 18 vjeç e lart. Pjesa më e madhe e të kthyerve janë punësuar në bujqësi dhe ndërtim. Por nga tabela vihet re që përqindja e emigrantëve të punësuar në sektorin e bujqësisë është dyfishuar pas kthimit në Shqipëri, ndërsa ajo në sektorin e punësimit është përgjysmuar.

Pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë në vendet e migrimit kanë punuar në sektorin e ndërtimit. Edhe pas kthimit në Shqipëri, punësimi në këtë sektor zë një përqindje të konsiderueshme, por vetëm gjysma e emigrantëve të kthyer janë integruar përsëri në këta sektorë. Sektori me punësimin më të lartë pas kthimit është bujqësia, madje përqindja e emigrantëve të kthyer të punësuar në këtë sektor është dyfishuar krahasuar me atë të punësimit në vendet e emigrimit. Gjithashtu vihet re që numri i të punësuarve në këta dy sektorë ka qenë më i lartë para kthimit. Punësimi i emigrantëve shqiptarë të kthyer në vend në sektorë të tjerë të industrisë duket se ka rënë ndjeshëm. Vihet re veçanërisht një rritje e punësimit të emigrantëve shqiptarë të kthyer në sektorët e tregtisë me pakicë dhe në veprimtari të tjera biznesi.

Tabela 4: Shpërndarja e emigrantëve të kthyer sipas aktiviteteve

Sektorët e industrisë	Vendi i fundit i emigrimit	Pas kthimit
Bujqësi, gjueti dhe veprimtari të tjera shërbimi	14.6 %	30.7 %
Ndërtim	44.3 %	22.6 %
Shitje, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve dhe motorëve; shitje me pakicë e karburantit	1.8 %	2.6 %
Tregti me pakicë, përveç automjeteve dhe motorëve; riparim i sendeve	2.9 %	10.6 %
Hoteleri dhe restorante	12.0%	11.3%
Transport tokësor; transport nëpërmjet tubacioneve	3.0%	4.8%
Veprimtari të tjera biznesi	2.2%	6.1%
Sektorë të tjerë të industrisë	19.0%	6.6%
E pavlefshme	0.2%	4.6%
Gjithsej	100%	100%


Burimi: INSTAT, 2013

3. Potencialet e zhvillimit të vetëpunësimit sipas rajoneve

Për të siguruar rritjen e punësimin në përgjithësi dhe atë të vetëpunësimin në veçanti, duhet të konsiderohen specifikat sipas secilit rajon, në mënyrë që të dallohen shtigjet e duhura. Për këtë qëllim është e nevojshme që të identifikohen, nxiten, menaxhohen dhe shfrytëzohen potencialet zhvillimore të rajoneve të veçanta me nevoja specifike zhvillimore. Kështu do të bëhet e mundur që shkalla e punësimin apo/dhe vetëpunësimin të rritej, pavarësisht diferencave rrethore që ekzistojnë sipas rajoneve të ndryshme.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet PBB/frymë në nivel qarku për Shqipërinë në vitin 2016. Vihet re se nivelin më të lartë të PBB/frymë e mban Qarku i Tiranës me 699 mijë lekë për frymë, qark i cili i përket AZHR 2, ndërsa nivelin më të ulët të PBB/frymë e mban Qarku i Kukësit, pjesë e AZHR 1, me vetëm 314 mijë lekë për frymë, ose më pak se gjysma e nivelit të Qarkut të Tiranës. Shifrat tregojnë për disbalanca të mëdha të nivelit të mirëqenies ndërmjet qarqeve, tregues ky për nevojën për marrjen e masave për ndryshim.

Grafiku 30: PBB/frymë sipas qarqeve në mijë lekë, 2016



Burimi: INSTAT, 2017

Më poshtë paraqitet struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe katër rajoneve të vendit për vitin 2016.

Tabela 5: Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve, 2016

Rajoni	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse, Përpunuese, Energjia, Uji	Ndërtimi	Tregtia, Transporti, Hoteleri	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiarë dhe të sigurimit	Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike	Adm. Publike, Arsimi, Shëndëtiesia, etj	Arte, argëtim, çlodhje, etj
AZHR 1	33.1%	13.9%	10.6%	13.7%	2.7%	2.3%	5.8%	2.8%	13.3%	1.9%
AZHR 2	9.2%	13.6%	11.8%	21.2%	4.8%	3.3%	7.8%	10.4%	13.9%	4.1%
AZHR 3	43.1%	12.3%	7.3%	13.4%	2.1%	2.0%	4.6%	1.8%	11.3%	2.1%

AZHR 4	37.1%	16.2%	8.0%	16.1%	1.5%	2.4%	5.5%	2.7%	9.0%	1.5%
---------------	-------	-------	------	-------	------	------	------	------	------	------

Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

3.1. Prioritetet sektoriale për AZHR 1


AZHR 1 përbëhet nga tri qarqe: Qarku i Kukësit, Lezhës dhe Shkodrës, të cilat kanë në përbërje të tyre gjithsej 11 bashki. Nga këto bashki vetëm 2 prej tyre nuk kanë kaluar ende në proces hartimi të PPV-së, ndërkohë që bashkitë e tjera i kanë miratuar PPV-të përkatëse, pavarësisht se 5 prej tyre i kanë publikuar për qytetarët, ndërsa 4 janë ende në proces zbardhjeje.

Qarku i Kukësit përbëhet nga bashkitë e Kukësit, Hasit dhe Tropojës. Bashkia e Kukësit dhe ajo e Tropojës kanë miratuar dhe publikuar për qytetarët Planin e Përgjithshëm Vendor, ku përshkruhen prioritetet për zhvillim të mëtejshëm ekonomik, ndërsa Bashkia e Hasit ende nuk ka kaluar në proces hartimi të PPV-së.

Qarku i Lezhës përbëhet nga Bashkia e Lezhës, Kurbinit dhe Mirditës. Të trija këto bashki e kanë miratuar PPV-në në të cilin dallohen prioritetet sektoriale të vendosura nga to, por vetëm për Bashkinë e Lezhës ky dokument është bërë publik për qytetarët, ndërsa për dy bashkitë e tjera PPV-të janë ende në proces zbardhjeje.

Qarku i Shkodrës përbëhet nga Bashkia Shkodër, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë dhe Vau i Dejës. Nga të gjitha këto bashki, vetëm ajo e Fushë-Arrëzës nuk ka kaluar ende në proces hartimi të PPV-së, ndërsa bashkitë e tjera e kanë miratuar PPV-ne, por vetëm Bashkia e Shkodrës dhe ajo e Malësisë së Madhe e kanë publikuar për qytetarët, ndërsa Bashkia e Pukës dhe e Vaut të Dejës, pavarësisht miratimit, nuk i kanë publikuar ende PPV-të përkatëse për qytetarët.

Grafiku 31: Struktura e VSHB-së për AZHR 1, 2016



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Vlera e Shtuar Bruto për vitin 2016 në AZHR 1 përbëhet në masën 33.1% nga dega e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit. Kjo shifër tregon për rëndësinë e madhe që ka kjo degë në ekonominë e këtij rajoni. Bujqësia dhe blegtoaria kanë potencial të madh zhvillimi socio-ekonomik për zonën,

por megjithatë ngelet një sektor që ka nevoja për ndërhyrje në organizimin e tij si pasojë e problemeve strukturore dhe organizative. Zona specifike të këtij rajoni, si për shembull zona kodrinore e Bytyçit në Qarkun e Kukësit, veçohen për mundësinë për të zhvilluar pylltarinë, sidomos për rritjen e drurëve për ngrohje, gjë që përveç prodhimit të lëndës djegëse së rinovueshme, do të përmirësonte edhe cilësinë e tokës.

Dega e industrisë nxjerrëse, përpunimit, energjisë dhe ujit përbëjnë peshë të konsiderueshme në VSHB-në e këtij rajoni, me 13.9%, shifër relativisht e ulët kjo për potencialet e zonës. Aktivitetet kryesore janë të përqendruara në industrinë e nxjerrjes së mineraleve, lidhur kjo edhe me praninë e minierave në zona të ndryshme të rajonit dhe më pak në atë të përpunimit të peshkut në zonën e Shëngjinit dhe të industrisë tekstile dhe të këpucëve. Lidhur me këtë degë, vlen të përmendet se Bashkia e Shkodrës ka vendosur si përparësi të saj rivitalizimin e ish-zonës industriale, për ta kthyer në një zonë me përparësi zhvillimin ekonomik dhe të shërbimeve tregtare dhe industriale të lehta.

Dega e tregtisë, transportit dhe hotelerisë përbën 13.7% të VSHB-së për AZHR 1 për vitin 2016. Kjo shifër lidhet me promovimin e turizmit malor dhe atij natyror veçanërisht vitet e fundit në zona të ndryshme të rajonit. Zhvillimi i sektorit turistik paraqet edhe një ndër sfidat kryesore të zhvillimit të këtij rajoni, jo vetëm për ndikimin e tij ekonomik, por edhe për mjedisin në të cilin ai po zhvillohet, në kuadër të mbrojtjes së tij. Prioritet duhet të vihet në identifikimin e qendrave kryesore të zhvillimit turistik, hartimin e udhëzimeve për menaxhimin e shtigjeve historike, infrastrukturave të shërbimit dhe strukturave të pritjes. Zhvillimi i të ashtuquajturit “turizëm i butë”, i cili ka të bëjë me zhvillim e aktiviteteve rekreative në përputhje me mjedisin natyror, si hiking, vozitja, rafting, çiklizmi mund të konsiderohen si alternativa të mira për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit.

Turizmi shikohet si një sektor prioritar për zhvillimin ekonomik të zonës dhe si një vlerë e shtuar e sektorëve të tjerë. Pra koncepti i turizmit për këtë qark nuk shikohet vetëm si sektorial, por i lidhur dhe bashkërenduar edhe me sektorët e tjerë. Zhvillimi i turizmit krijon mundësi të ndryshme për ngritjen e bizneseve të lidhura me të, duke ndikuar në rritjen e punësimit apo/dhe vetëpunësimit në rajon.

Gjithashtu në mbështetje të zhvillimit të transportit, prioritet për këtë rajon është shfrytëzimi i transportit rrugor, hekurudhor dhe atij ujor, nëpërmjet ndërtimit të një terminali multimodal ndërkombëtar për lidhjen e transportit rrugor dhe hekurudhor, si dhe ndërtimit të një terminali ujor në liqenin e Shkodrës. Terminali ujor nga ana tjetër pritet t'i japë hov edhe turizmit në këtë rajon, duke e bërë një mundësi të mirë shfrytëzimi për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit.

Nga ana tjetër vihet re që degët me peshën më të ulët në VSHB-në e AZHR 1 për vitin 2016 janë aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike me 2.8%; informacioni dhe komunikacioni me 2.7%; aktivitetet financiare dhe të sigurimit me 2.3%; artet, argëtimi dhe çlodhja me 1.9%. Këto shifra tregojnë se pjesa më e madhe e degëve që u përkasin sektorit të shërbimeve nuk luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë e këtij rajoni.

Megjithatë degës së informacionit dhe komunikacionit pritet ti kushtohet gjithnjë e më shumë rëndësi, duke e parë këtë degë si një objektiv strategjik për konkurrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik, veçanërisht në Bashkinë e Shkodrës, sikurse është hartuar edhe në planin e zhvillimit të territorit të kësaj bashkie.

3.2. Prioritetet sektoriale për AZHR 2


AZHR 2 përbëhet nga tri qarqe: Qarku i Dibrës, Durrësit dhe Tiranës, të cilat kanë në përbërje të tyre gjithsej 12 bashki. Nga këto bashki vetëm 1 prej tyre nuk kanë kaluar ende në proces hartimi të PPV-së, njëra prej tyre është në proces hartimi, dy janë në proces miratimi, ndërkohë që bashkitë e tjera i kanë miratuar PPV-të përkatëse, pavarësisht se 5 prej tyre i kanë publikuar për qytetarët, ndërsa 2 janë ende në proces zbardhjeje.

Qarku i Dibrës përbëhet nga Bashkia e Dibrës, Klosit, Matit dhe Bulqizës. Tri bashkitë e para të renditura i kanë hartuar dhe miratuar PPV-të përkatëse, por vetëm Bashkia e Dibrës dhe ajo e Matit i kanë zbardhur për qytetarët, ndërsa Bashkia e Klosit është ende në proces e sipër. Përsa i përket Bashkisë së Bulqizës, ajo ende nuk është në proces hartimi të PPV-së.

Qarku i Durrësit përbëhet nga Bashkia e Durrësit, Krujës dhe Shijakut. Në këtë qark, vetëm Bashkia e Krujës ka miratuar dhe publikuar PPV-në, duke bërë të mundur që qytetarët e saj të njihen me prioritetet sektoriale. Përsa u përket dy bashkive të tjera, ato janë ende në proces miratimi të PPV-ve përkatëse.

Qarku i Tiranës ka në përbërje të tij Bashkinë e Tiranës, Vorës, Kamzës, Rrogozhinës dhe Kavajës. Nga këto bashki, vetëm ajo e Tiranës, Rrogozhinës dhe Kavajës kanë miratuar PPV-të përkatëse, por Bashkia e Kavajës ende nuk e ka bërë publike për qytetarët PPV-në e saj. Bashkia e Vorës është ende në proces hartimi të PPV-së, ndërsa ajo e Kamzës ende nuk ka kaluar në këtë proces.

Grafiku 32: Struktura e VSHB-së për AZHR 2, 2016



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Për AZHR 2 duket se peshat që zënë degë të ndryshme të ekonomisë në strukturën e VSHB-së për vitin 2016 janë më të përafërta me njëra-tjetrën në krahasim me tri rajonet e tjera. Kjo vjen për shkak të larmishmërisë së degëve që ushtrohen në këtë rajon.

Dega e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit zë peshën më të ulët në strukturën e VSHB-së në krahasim me rajonet e tjera, konkretisht në një masë prej 9.2%. Kjo është një degë me prioritet të veçantë vetëm për qarkun e Dibrës, megjithatë edhe për Qarkun e Tiranës kjo degë shikohet me prioritet, sidomos në drejtim të rritjes së cilësisë ushqimore. Objektivi strategjik për sistemin e bujqësisë është vendosur për të përcaktuar dhe për të promovuar një sistem me cilësi të lartë të prodhimit të ushqimit (duke përfshirë edhe bujqësinë organike) që është në gjendje të shkojë me kërkesën në rritje të ushqimit vendor, duke krijuar mundësi punësimi në bujqësi dhe në bioenergjinë e prodhimit. Synohet zhvillimi i mëtejshëm i përpunimit primar të prodhimeve bujqësore dhe të qumështit, si dhe nxjerrja në treg e tyre nëpërmjet sigurimit të strukturave për modernizimin dhe kualifikimin inovativ në sektorët organikë.

Dega e tregtisë, transportit dhe hotelerisë është dega që zë peshën më të lartë të VSHB-së për vitin 2016 në këtë rajon, konkretisht në masën 21.2%. Ajo renditet ndër sektorët më prioritarë të këtij rajoni, për shkak të pozicionimit gjeografik pjesërisht në vijën bregdetare të Adriatikut: praninë së portit detar të Durrësit që shërben si një pikë kyçe transporti dhe tregtie dhe zhvillimit të turizmit bregdetar, praninë së aeroportit ndërkombëtar, i cili përveç ndikimit në aktivitetin e transportit, lidhet edhe me zhvillimin e hotelerisë në zonë; përqendrimit të një pjese të madhe të aktiviteteve tregtare në rajon, veçanërisht në kryeqytetin e vendit.

Shërbimi i hotelerisë është rritur vitet e fundit kryesisht si pasojë e zhvillimit të turizmit, i cili konsiderohet si një ndër sektorët më strategjikë për këtë rajon dhe me mundësi reale zhvillimi falë pasurive të larmishme të rajonit, duke filluar që nga ato malore, bregdetare, arkeologjike, historike e kulturore.

Trashëgimia natyrore lejon një përdorim të gjerë dhe të përhapur gjatë gjithë vitit, si hiking; trekking; sportet dimërore, si për shembull në zonën malore të Qafështamës; sportet ujore përgjatë lumenjve, përrenjve dhe vijës bregdetare; zhvillimin e turizmit ujor në zonën e ujërave termale si në atë të fshatit Bikaj si dhe falë trashëgimisë historike e kulturore, si mbetjet arkeologjike, kështjella, ndërtesat fetare dhe banesat tradicionale. Turizmi ngelet një sektor me mundësi potenciale të mëdha shfrytëzimi dhe që garanton rritje të shkallës së punësimit apo/dhe vetëpunësimit.

Ndërtimi luan gjithashtu rol të rëndësishëm në ekonominë e këtij rajoni, duke përbërë 11.8% të VSHB-së për vitin 2016. Kjo lidhet kryesisht me përqendrimin e popullsisë në kryeqytetin e vendit, gjë që shkakton rritjen e kërkesës për apartamente, si dhe me zhvillimin e turizmit bregdetar, veçanërisht në Bashkinë e Durrësit. Kjo ka sjellë edhe zhvillimin e aktiviteteve të pasurive të paluajtshme, degë e cila zë një peshë prej 7.8% në strukturën e VSHB-së për vitin 2016.

Në këtë rajon peshë të rëndësishme përbën edhe dega e aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike, me një peshë prej 10.4%, më e larta kjo ndër të katërt rajonet e Shqipërisë, lidhur kryesisht me përqendrimin e institucioneve të kësaj dege në kryeqytetin e vendit. Ky rajon ka në

përbërje të tij edhe peshën më të lartë të degës së arteve, argëtimit, çlodhjes në krahasim me tri rajonet e tjera, konkretisht në masën 4.1%, kryesisht lidhur kjo me praninë e institucioneve të arteve, argëtimit dhe bizneseve në fushën e argëtimit dhe çlodhjes në krahasim me rajonet e tjera të vendit.

3.3. Prioritetet sektoriale për AZHR 3

AZHR 3 përbëhet nga tri qarqe: Qarku i Beratit, Elbasanit dhe Korçës, të cilat kanë në përbërje të tyre gjithsej 18 bashki. Nga këto bashki vetëm 10 prej tyre i kanë miratuar PPV-të përkatëse, dhe i kanë publikuar për qytetarët, dy janë në proces miratimi, dy janë në proces hartimi, ndërsa 4 bashki të këtij rajoni nuk kanë kaluar ende në proces hartimi të PPV-së.

Qarku i Beratit është pjesë përbërëse e AZHR 3 dhe përbëhet nga Bashkia e Beratit, Urës Vajgurore, Skraparit, Poliçanit dhe Kuçovës. Të gjitha bashkitë që bëjnë pjesë në Qarkun e Beratit i kanë miratuar dhe publikuar për qytetarët PPV-të përkatëse, duke bërë të mundur që ata të njihen me sektorët prioritarë për zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe të konsiderojnë mundësitë më të mëdha që ekzistojnë për vetëpunësim.


Qarku i Elbasanit përbëhet nga Bashkia e Elbasanit, Belshit, Cërrikut, Gramshit, Librazhdit, Peqinit dhe Prrenjasit. Bashkia e Elbasanit, Cërrikut, Librazhdit dhe ajo e Prrenjasit kanë miratuar dhe publikuar për qytetarët PPV-të përkatëse, ndërsa Bashkia e Belshit është ende në proces miratimi. Bashkia e Gramshit është në proces hartimi të PPV-së së saj, ndërsa ajo e Peqinit ende nuk ka kaluar në këtë proces.

Qarku i Korçës përbëhet nga Bashkia e Korçës, Devollit, Kolonjës, Maliqit, Pogradecit dhe Pustecit. Bashkia e Korçës është e vetmja në këtë qark që ka miratuar dhe publikuar PPV-në, ndërkohë që ajo e Pogradecit është ende në proces miratimi. Bashkia e Kolonjës është në proces hartimi, ndërsa bashkitë e Devollit, Maliqit dhe Pustecit nuk kanë filluar ende procesin e hartimit të PPV-ve të tyre për të identifikuar ndër të tjera prioritetet sektoriale.

Dega e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit paraqitet me rëndësi të madhe ekonomike për këtë rajon e rrjedhimisht shikohet me prioritetet nga autoritetet përkatëse që i përkasin atij, veçanërisht në zonat rurale, pasi mundësojnë edhe punësimin e pjesës më të madhe të popullsisë së këtyre zonave. AZHR 3 është rajoni me peshën më të lartë të kësaj dege në strukturën e VSHB-së për vitin 2016 në krahasim me tri rajonet e tjera, duke përbërë 43.1% të saj. Kjo tregon për përqendrimin e lartë të aktiviteteve ekonomike pikërisht në këtë degë, e lidhur edhe me kushtet natyrore të kësaj zone.

Objektiv strategjik për këtë rajon është përcaktuar rritja e sipërfaqes bujqësore të shfrytëzueshme për të rritur madhësinë mesatare të fermave dhe përmirësimin teknologjik e rrjedhimisht prodhimtarinë e tyre në kuadër të kapërcimit të problemeve që vijnë për shkak të fragmentarizimit dhe teknologjisë së vjetruar. Parashikohet që këto zona të kthehen në njësi grumbullimi, frigoriferimi dhe përpunimi të produkteve bujqësore dhe blegtorale, duke u kthyer në një mundësi shfrytëzimi për rritjen e punësimit apo/dhe vetëpunësimit.

Grafiku 33: Struktura e VSHB-së për AZHR 3, 2016



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Me prioritet shikohet edhe bujqësia organike, falë kushteve të favorshëm klimaterike të zonës, gjeomorfologjisë së përshtatshme të tokës, si dhe njohurive tradicionale të fermerëve vendas. Këto avantazhe mund të shfrytëzohen më së miri për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj nëndege të bujqësisë për të plotësuar kërkesën në rritje për produkte bio-organike të tregjeve mesdhetare e evropiane falë zhvillimeve të vullshme të turizmit kulinar dhe atij elitari.

Përsa i përket Bashkisë së Kuçovës, vlen të theksohet se ndotja e tokës bujqësore dhe ujërave vaditëse nga prania e puseve të naftës dhe zonave industriale pa hapësirë buferike rreth tyre përbën rrezik për produktivitetin e tokës dhe cilësinë e produkteve bujqësore.

Tregtia, transporti dhe hoteleria përbëjnë 13.4% të strukturës së VSHB-së për vitin 2016 dhe kjo peshë është rritur veçanërisht vitet e fundit për shkak të zhvillimit të turizmit kulturor në Bashkinë e Korçës dhe të Beratit, e sidomos që nga shpallja e qytetit të Beratit si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Botërore. Kjo degë përbën një prioritet të veçantë për rajonin falë parashikimit të bashkive të ndryshme për të përmirësuar sistemin e transportit dhe logjistikën e tij në kuadër të zgjidhjes së problemit me koordinimin për linjat e transportit dhe veçanërisht falë zhvillimit të turizmit që lidhet në mënyrë direkte me zhvillimin e hotelerisë. Është vendosur si objektiv strategjik ndërtimi i Stacionit Multimodal në afërsi të aeroportit të Korçës, si dhe krijimi i një zone të re aktivitetesh të shitjes me shumicë në këtë qytet që pritet t'i japë hov zhvillimit të tregtisë.

Turizmit po i jepet gjithnjë e më shumë rëndësi nga autoritete përkatëse, veçanërisht në qarkun e Beratit dhe Korçës falë pasurive natyrore e trashëgimisë kulturore që lejon zhvillimin e aktiviteteve të shumëllojshme të lidhura me të duke rritur mundësitë për punësim apo/dhe vetëpunësim. Duke filluar që nga më shumë se dy dekada, Qarku i Beratit ka pësuar një rritje të sektorit të shërbimeve, si pasojë e zhvillimit të turizmit kulturor, natyror e fetar, nxitur nga

shpallja e qytetit të Beratit si pjesë e Trashëgimisë Kulturore Botërore, si dhe nga shtrirja ndërmjet Parkut Kombëtar të Tomorrit dhe Malit të Shpiragut.

Dega e industrisë nxjerrëse, përpunuese, energjisë dhe ujit konsiderohet gjithashtu si një degë prioritare për rajonin falë pasurive minerare të tij dhe sidomos në Qarkun e Beratit dhe të Korçës me rëndësi gjithnjë e më të madhe falë zbulimeve minerare të kohëve të fundit. Kjo degë përbën 12.3% të strukturës së VSHB-së së vitit 2016 për AZHR 3. Veçanërisht në Bashkinë e Kuçovës industria është një sektor mjaft i rëndësishëm, lidhur kjo me zbulimin e rezervave të naftës në vitin 1928 dhe që e ka bërë këtë bashki të renditet e para për numrin më të lartë të puseve të naftës në nivel kombëtar, në 1090 të tillë. Ky sektor punëson rreth 17% të të punësuarve në Bashkinë e Kuçovës (në bazë të llogaritjeve të INSTAT për vitin 2011) duke dëshmuar për rëndësinë e tij ekonomike në këtë zonë.

Edhe dega e argëtimit, arteve dhe çlodhjes përbën një mundësi për rritjen e punësimit apo/dhe vetëpunësimit në rajon, sidomos për Qarkun e Korçës kjo degë konsiderohet si një mundësi potenciale për zhvillim të mëtejshëm ekonomik falë parashikimit për ndërtimin e një Qendre Rajonale Ekspozitash në hyrje të qytetit të Korçës.

3.4. Prioritetet sektoriale për AZHR 4

AZHR 4 përbëhet nga tri qarqe: Qarku i Fierit, Gjirokastrës dhe ai i Vlorës, të cilat kanë në përbërje të tyre gjithsej 20 bashki. Nga këto bashki 8 prej tyre kanë miratuar dhe publikuar për qytetarët PPV-të përkatëse, tri janë në proces hartimi, ndërsa 9 të tjerat nuk kanë kaluar ende në proces hartimi të PPV-ve të tyre.

Qarku i Fierit përbëhet nga Bashkia e Fierit, Divjakës, Lushnjes, Mallakastrës, Patosit dhe Roskovecit. Bashkia e Fierit, Divjakës dhe ajo e Lushnjes kanë miratuar dhe publikuar për qytetarët PPV-të përkatëse, ndërsa Bashkitë e tjera të këtij qarku ende nuk kanë kaluar në proces hartimi.

Qarku i Gjirokastrës përbëhet nga Bashkia e Gjirokastrës, Dropullit, Këlcyrës, Libohovës, Memaliajt, Përmetit dhe Tepelenës. Bashkia e Gjirokastrës është e vetmja në këtë qark që ka miratuar dhe publikuar PPV-në. Bashkia e Dropullit, Këlcyrës dhe Përmetit janë në fazën e hartimit të PPV-ve përkatëse, ndërsa Bashkia e Libohovës, Memaliajt dhe e Tepelenës ende nuk ka kaluar në fazën e hartimit të PPV-ve të tyre.


Qarku i Vlorës ka në përbërjen e tij Bashkinë e Vlorës, Selenicës, Delvinës, Finiqit, Himarës, Konispolit dhe Sarandës. Bashkia e Vlorës, Himarës, Konispolit dhe Sarandës kanë miratuar dhe bërë publike PPV-të e tyre duke bërë të njohur qytetarët prioritetet sektoriale të vendosura të cilat garantojnë mundësi më të mëdha për zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe mundësi më të mëdha punësimi apo/dhe vetëpunësimi. Tri bashkitë e tjera të këtij qarku ende nuk kanë kaluar në proces hartimi të PPV-ve përkatëse.

AZHR 4 ka në strukturën e tij të VSHB-së kryesisht degën e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit në peshën 37.1%, që tregon se kjo degë luan rolin kryesor në aktivitetin ekonomik të këtij rajoni. Në lidhje me këtë degë është vendosur si objektiv strategjik i zhvillimit bujqësor dhe blegtoral rritja

e sipërfaqes së tokave bujqësore të shfrytëzuara për rritjen e madhësisë mesatare të fermave dhe të prodhimit të tyre, si dhe zbatimin të praktikave të mira bujqësore, si krijimi i njësive të grumbullimit, frigoriferimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore duke mbajtur në konsideratë ndalimin e ndërtimeve që nuk i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit bujqësor dhe blegtoral. Në funksion të rritjes së prodhimit bujqësor dhe në mbështetje të tij janë hedhur hapa për zhvillimin e agro-industrisë, veçanërisht në përpunimin e vajit të ullirit. Po kështu, fabrikat e përpunimit të frutave për prodhimin e lëngjeve freskuese që deri më tani importojnë lëndën e parë, mund të shfrytëzohen për të ofruar produktet primare nga fermat e zonës.

Kjo degë mbetet prioritet për rajonin, pasi shërben si burimi kryesor i të ardhurave për të vetëpunësuarit në sektorin e bujqësisë, dhe që nëpërmjet synimit për të reduktuar fragmentarizimin e fermave bujqësore në qark, pritet të rrisë akoma më shumë shkallën e punësimit dhe nivelin e të ardhurave për qytetarët

Grafiku 34: Struktura e VSHB-së për AZHR 4, 2016



Burimi: INSTAT, 2018 dhe përpunim i autorëve

Industria nxjerrëse, përpunuese, energjia dhe uji përbëjnë një degë me prioritet për rajonin për shkak të pasurisë së hidrokarbureve dhe hidrocentraleve që gjenden në zona të ndryshme të tij. Prania e një nga rezervave më të mëdha naftëmbajtëse të Evropës në zonën e Patos-Marinzës dhe e dy burimeve të rëndësishme të gazit natyror në zonën e Frakullës dhe Murteziës e bëjnë rajonin me potencial të lartë shfrytëzimi për zhvillim ekonomik dhe rritje të punësimit. Këto pasuri kanë bërë të mundur përfshirjen në projektin Trans-Adriatik, i cili parashikohet të sjellë përfitime strategjike për rajonin në tërësi, si rritje të mundshme të PBB-së, rritje të punësimit, investime sociale dhe mjedisore dhe investime në infrastrukturën rrugore. Gjithashtu, prania e hidrocentraleve në këtë rajon konsiderohet e një rëndësie të veçantë, pasi kontribuojnë në pavarësinë dhe mbizotërimin energjetik të vendit.

Dega e tregtisë, transportit dhe hotelerisë kanë rëndësi tepër të veçantë për ekonominë e këtij rajoni, e shprehur kjo edhe në peshën relativisht të lartë të kësaj dege në strukturën e VSHB-së, ku për vitin 2016 llogaritet në 16.1%. Tregtia dhe transporti lidhen kryesisht me pozicionin gjeografik të këtij rajoni, praninë e portit detar të Vlorës, zhvillimin e tregtisë dhe transportit së produkteve bujqësore të Qarkut të Fierit brenda dhe jashtë territoreve kombëtare, përqendrim të aktiviteteve tregtare në të, të cilat krijojnë mundësi për zhvillim të mëtejshëm ekonomik. Synohet që të rritet pesha e tregtisë dhe transportit të produkteve bujqësore e blegtorale, falë zhvillimit në rritje të sektorit bujqësor, që konsiston në grumbullimin, magazinimin frigoriferik të produkteve dhe shitjen apo transportin jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe jashtë kufijve të Shqipërisë, si në Kosovë e Kroaci. Zhvillimi i transportit logjistik, i reflektuar edhe në numrin e lartë të bizneseve të transportit, mbetet një prioritet dhe mundësi e mirë shfrytëzimi për mbështetjen e aktiviteteve ekonomike lokale që mund të përfitojnë për të rritur tregtimin e produkteve apo/dhe shërbimeve të tyre.

Zhvillimi i hotelerisë lidhet kryesisht me zhvillimin e vazhdueshëm të turizmit, i cili është një sektor prioritar për rajonin, falë pasurive natyrore, monumenteve të kulturës dhe zonave arkeologjike që ofrojnë potenciale për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme me ndikim pozitiv në rritjen e punësimit apo/dhe vetëpunësimit. Veçanërisht Qarku i Gjirokastrës dhe i Fierit me trashëgimi historike e kulturore dhe qyteti i Përmetit me pasurinë e ujërave termale me veti kuruese ofrojnë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të lidhura me turizmin historik, kulturor, natyror, që krijojnë mundësi për rritjen e punësimit apo/dhe vetëpunësimit. Nga ana tjetër edhe shpatet e Lunxhërisë mund të funksionojnë si atraksione turistike falë shndërrimit në bujtina të ndërtesave me arkitekturë tradicionale të veçantë.

Bashki të këtij rajoni kanë si objektiv strategjik që të sigurojnë një larmishmëri sa më të madhe të shërbimeve për një zhvillim sa më fleksibël dhe në përputhje me ndryshime të mundshme, si ato mjedisore apo ekonomike.

4. Gjetje dhe Rekomandime

Integrimi i të rinjve në tregun e punës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me nivelin e tyre të aftësive në përgjigje të kërkesave teknike të sektorëve ekonomikë. Në këtë perspektivë suksesi në adresimin e kësaj problematike në nivel rajonal duhet të jetë e sinkronizuar me strategjitë kombëtare dhe sektoriale dhe programet për ngritjen e kapaciteteve mbështetur nga donatorët e programet e zhvillimit. Mbështetur në analizën rajonale të bërë në këtë raport disa nga gjetjet kryesore dhe rekomandimet e dala janë listuar më poshtë.

4.1. Gjetjet

- **Pesha e punëkërkuësve të grupmoshës 20-34 vjeç ka ardhur në rënie gjatë viteve të fundit.** Duke marrë në konsideratë faktin që ka një ulje të papunësisë vitet e fundit, ky ndryshim mund të vijë si rezultat i rritjes së përfshirjes në tregun e punës të personave të papunë, por nga ana tjetër tregon që ka pak iniciativa për të përfshirë individët në moshë pune jashtë forcave të punës në tregun e punës. Faktorë tjetër që mund të ketë ndikuar në këtë trend mund të jetë edhe numri i madh i studentëve që kanë shkuar për studime jashtë vendit, ku për vitin 2012-2017 mesatarisht kanë ikur mbi 20 mijë student për studime ¹⁴
- **Ka një diferencë të lartë të pjesëmarrjes në forcat e punës me bazë gjinore.** Kjo diferencë do të ndikojë në një zhvillim jo të qëndrueshëm në periudhën afatgjatë. Diferenca ndërmjet dy gjinive vihet re edhe në nivelin e tyre të punësimit, ku duket se meshkujt janë më të angazhuar në tregun e punës se femrat. Vlen të theksohet se në totalin e të punësuarve meshkuj, pesha e tyre e të vetëpunësuarve është 45 pikë përqindje më e lartë se pesha e të punësuarave femra, ose më konkretisht meshkujt e vetëpunësuar rezultojnë të përbëjnë rreth 42% të të punësuarve total meshkuj, ndërsa femrat vetëm 27% të të punësuarave të femrave në total. Në këtë kuadër mund të thuhet se jo vetëm që femrat janë më të tërhequra nga tregu i punës, por edhe që marrja përsipër nga ana e tyre për t'u vetëpunësuar është në nivele të ulëta në krahasim me gjininë tjetër. Shkalla e papunësisë ndër vite rezulton herë më e lartë për meshkujt dhe herë për femrat, megjithatë duket se në vitet e fundit meshkujt e kanë pasur më të vështirë për të gjetur një punë në krahasim me femrat. Faktor që ka ndikuar në këtë fenomen është edhe struktura e tregut të punës në Shqipëri, e cila është e mbështetur në disa raste në sektorë me përdorim të lartë të krahut të punës dhe të mbizotëruar nga punonjëset femra siç janë fasoneria apo sektori bujqësor në të cilin edhe pse ka më shumë meshkuj në forcat e punës, femrat kanë një përqindje më të lartë të punësimit.
- **Ka mospërputhje mes kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.** Nga të dhënat që vijnë nga tregu i punës dhe arsimit rezulton se një pjesë e madhe e të punësuarve shqiptarë përballen me një treg pune për të cilin nuk kanë studiuar apo të jenë trajnuar apo specializuar. Mungesa e punësimit vertikal, ku të punësuarit të kontribuojnë në tregun e punës bazuar në dijet e marra në sistemet arsimore, ndikon negativisht në produktivitetin

¹⁴ <http://data.uis.unesco.org/>

e tyre. Kjo sjell për pasojë paga më të ulëta në krahasim me rastet kur puna përputhet me nivelin arsimor.

- **Shqipëria karakterizohet edhe nga një treg pune me diskriminim gjinor në paga.** Vihet re se femrat paguhen mesatarisht më pak se meshkujt për të njëjtën punë të kryer. Barazia gjinore është një nga prioritetet e objektivave të mijëvjeçarit¹⁵ dhe ka marr një vëmendje të veçantë edhe nga BE e cila në vitin 2017 ka ndërmarr hapa konkrete për reduktimin e diferencave të pagës me bazë gjinore¹⁶.
- **Ndërmarrjet e vogla zënë peshën më të lartë përse i përket numrit të ndërmarrjeve.** Kjo gjë që tregon se shumica e ndërmarrjeve shqiptare përbëhet nga ekonomitë e vogla familjare ndërkohë që përse i përket peshës së të punësuarve ajo rezulton gati e njëjtë me atë të ndërmarrjeve me mbi 50 punonjës që zënë vetëm 1.1% të totalit të ndërmarrjeve. Ajo që vihet re është pesha me bazë gjinore e të vetëpunësuarve, ku nga raporti i bankës botërore rezulton që ka një mospërputhje të lartë mes të vetëpunësuarve meshkuj dhe atyre femra më konkretisht me 42.7 dhe 27.1%.¹⁷
- **Numri i ndërmarrjeve sociale vijon të ngelet i ulët.** Ndërmarrjet sociale kanë marr një vëmendje të veçantë në kohët e sotme por në Shqipëri vazhdon të jetë në një nivel të ulët përfaqësimi duke bërë që kontributi i tyre në tregun shqiptar të punës të mos jetë në nivele të dëshiruara, megjithëse vihet re se punësimi i grupeve të pafavorizuara nga këto ndërmarrje ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Gjithsesi për këtë kategori, kërkohen studime më të thelluara mbi nivelet potenciale që mund të ketë ky sektor për tu zhvilluar në vend.
- **Integrimi i emigrantëve të kthyer në tregun e punë mbetet një problem i vazhdueshëm.** Kthimi i një pjese të madhe të emigrantëve shqiptarë në atdhe pas krizës financiare të vitit 2008 e ka gjetur tregun e punës të papërgatitur për t'i pritur ata, duke sjellë si pasojë punësimin e tyre kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe duke bërë të nevojshme ndërmarrjen e politikave shtetërore për trajnimin dhe integrimin e tyre në profesione të tjera. Edhe pse janë ndërmarrë nisma nga qeveria për këtë qëllim, është e nevojshme që kjo kategori të shndërrohet nga punëkërkues në punë-ofrues, bazuar në faktin që kanë një eksperiencë disa vjeçare në vendet e BE-së, njohin më mirë teknologjitë dhe tregjet e mallrave dhe shërbimeve dhe mund të mbështeten me grante apo kredi të buta për çeljen e bizneseve të tyre.

Përse i përket prioritetëve të rajonit të parë të zhvillimit, mund të theksojmë se ato janë të mbështetura mbi:

- **Zhvillimin e sektorit turistik,** kryesisht turizmit malor dhe atij natyror, i cili paraqet edhe një ndër sfidat kryesore të zhvillimit të këtij rajoni, jo vetëm për ndikimin e tij

¹⁵ <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals.html>

¹⁶ http://ec.europa.eu/newsroom/just/document.cfm?action=display&doc_id=48360

¹⁷ <http://documents.worldbank.org/curated/en/565231521435487923/pdf/124354-WP-P158508-PUBLIC-16-3-2018-10-13-39-WBLabormarkettrends.pdf>

ekonomik, por edhe për mjedisin në të cilin ai po zhvillohet, në kuadër të mbrojtjes së tij. Zhvillimi i aktiviteteve rekreative në përputhje me mjedisin natyror, si hiking, vozitja, rafting, çiklizmi mund të konsiderohen si alternativa të mira për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit në këtë rajon.

- **Mundësinë për të zhvilluar pylltarinë**, sidomos për rritjen e drurëve për ngrohje, gjë që përveç prodhimit të lëndës djegëse së rinovueshme, do të përmirësonte edhe cilësinë e tokës.
- **Mundësinë për të zhvilluar Industrinë nxjerrëse, përpunimit, energjisë dhe ujit**, të cilat përbëjnë peshë të konsiderueshme në VSHB-në e këtij rajoni me 13.9%, shifër relativisht e ulët kjo për potencialet e zonës.

Përsa i përket prioriteteve të rajonit të dytë të zhvillimit, mund të theksojmë se ato janë të mbështetura mbi:

- **Zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë, transportit dhe hotelarisë**, e lidhur kjo me praninë e portit detar të Durrësit dhe aeroportit ndërkombëtar të Rinasit, përqendrimin e një pjese të madhe të aktiviteteve tregtare veçanërisht në kryeqytetin e vendit, si dhe me zhvillimin e turizmit bregdetar, ujqor termal, malor, arkeologjik, historik e kulturor.
- **Zhvillimi i bizneseve novative në shërbim të bizneseve të tjera**. Këto biznese lejojnë të futen në qarkullim ekonomik një sërë biznesesh të tjera në sektor të ndryshëm të ekonomisë sidomos të lidhur me turizmin.
- **Mundësinë e ngritjes dhe promovimit të një sistemi me cilësi të lartë të prodhimit të ushqimit**, përfshirë këtu edhe bujqësinë organike, si dhe nxjerrjen në treg të tyre nëpërmjet sigurimit të strukturave për modernizimin dhe kualifikimin inovativ në sektorët organikë.
- **Zhvillimi në sektorin e ndërtimit**, i cili ka kontribuar gjithnjë e më shumë në ekonominë e rajonit, kryesisht si pasojë e përqendrimit të popullsisë në kryeqytetin e vendit dhe zhvillimit të turizmit bregdetar. Nga ana tjetër, rritja e kërkesës për apartamente nga ana e individëve rrit mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të pasurive të paluajtshme.

Përsa i përket prioriteteve të rajonit të tretë të zhvillimit mund të theksojmë se ato janë të mbështetura mbi:

- **Zhvillim e sektorit të bujqësisë**, si sektori me kontributin më të lartë në punësim për këtë rajon. Strategjia për rritjen e madhësisë mesatare të fermave dhe përmirësimin teknologjik pritet ti kthejë këto zona në njësi grumbullimi, frigoriferimi dhe përpunimi të produkteve bujqësore e blegtorale
- **Mundësinë e zhvillimit të bujqësisë organike** në veçanti falë kushteve të favorshme klimaterike, gjeomorfologjisë së tokës dhe njohurive tradicionale të fermerëve vendas, e cila nga ana tjetër mund të ndikohet nga nevoja për të plotësuar kërkesën në rritje për produkte bio-organike të tregjeve mesdhetare e evropiane.

- **Rritjen e përdorimit të pasurive natyrore e trashëgimisë kulturore të rajonit** që lejon zhvillimin e aktiviteteve sportive në zonat malore, parqet natyrore, kanionet e lumenjve, si dhe zhvillimin e turizmit historik e kulturor. Këto krijojnë mundësi të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të shërbimeve e veçanërisht të hotelerisë.
- **Zhvillim e sektorit të industrinë nxjerrëse, përpunuese, energjisë dhe ujit** e cila përbën vetëm 12.3% të strukturës së VSHB-së së vitit 2016, pavarësisht pasurive të konsiderueshme të zonës të lidhura me sektorin. Mundësitë për zhvillim janë në rritje edhe falë pasurive dhe zbulimeve minerare të viteve të fundit.

Përsa i përket prioriteteve të rajonit të katërt të zhvillimit mund të theksojmë se ato janë të mbështetura mbi:

- **Zhvillimin e mëtejshëm të turizmit**, falë pasurive natyrore, monumenteve të kulturës dhe zonave arkeologjike. Pasuria e ujërave termale me veti kuruese ofron mundësi që deri tani nuk janë shfrytëzuar në raport me potencialet që rajoni ofron.
- **Mundësinë për zhvillim të mëtejshëm të degës së tregtisë**, transportit dhe hotelerisë, lidhur kryesisht me pozicionin gjeografik, praninë e portit detar të Vlorës, zhvillimin e tregtisë dhe transportit së produkteve bujqësore brenda dhe jashtë territoreve kombëtare. Zhvillimi i transportit logjistik mbetet një prioritet dhe mundësi e mirë shfrytëzimi për mbështetjen e aktiviteteve ekonomike lokale në tregtimin e produkteve apo/dhe shërbimeve të tyre.
- **Rritjen e sipërfaqes së tokave bujqësore** të shfrytëzuara dhe zbatimit të praktikave të mira bujqësore, duke mbajtur në konsideratë ndalimin e ndërtimeve që nuk i shërbejnë ushtrimit të aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.
- **Potencialin e shfrytëzimit të pasurive në hidrokarbure dhe hidrocentrale**, të cilat kontribuojnë edhe në pavarësinë dhe mbizotërimin energjetik të vendit nga ana tjetër. Përfshirja në projektin Trans-Adriatik, parashikohet të sjellë përfitime strategjike për rajonin në tërësi, si rritje të mundshme të PBB-së, rritje të punësimit, investime sociale dhe mjedisore dhe investime në infrastrukturën rrugore.

4.2. Rekomandime

Disa nga rekomandimet e propozuara bazuar në analizën e bërë në nivel rajonal e në përputhje me kriteret e nxitjes së aktivitetit ekonomik pro-mjedisor janë:

- T'i kushtohet nga autoritetet shtetërore që orientojnë politikat e tregut angazhim proaktiv institucional në mbështetje të punëkërkuarve të papunë të rinj. Kjo mbështetje në nivel vendor duhet të jetë e harmonizuar me nevojat për aftësi të ekonomisë dhe tregut rajonal të punës.
- Duhet të rritet formimi profesional për të edukuar tek të rinjtë shprehinë bazë të punës dhe aftësitë e domosdoshme të sjelljes e komunikimit.

- Organizimi në nivel rajonal të Pakteve Rajonale të Punësimit dhe Formimit profesional duke sjellë në një platformë bashkëpunimi bizneset vendase, zyrat e punës, qendrat e formimit profesional dhe të rinjtë me ambicie për të krijuar sipërmarrjet e tyre prodhuese në tregun lokal.
- Në bashkëpunim me shkollat 9 vjeçare, ato të arsimit të mesëm të përgjithshëm e profesional dhe universiteteve rajonale, realizimi i sesioneve informuese mbi mundësitë e vetëpunësimit, për të minimizuar apatinë tek të rinjtë dhe për t'i mbështetur këta të fundit në tranzicionin drejt punës apo sipërmarrjes private.
- Hartimi i paketave informative për të rinjtë mbi të drejtat dhe detyrimet në tregun e punës, që nga planifikimi i një sipërmarrjeje deri tek regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit duke ofruar në paralel mbështetje me formim profesional, kurse të përkohshme afatshkurtra deri në 6-muaj, për të rinjtë në zonat rurale, veçanërisht ata që kanë tokë e janë në nevojë të trajnimeve bazë.
- Nxitje e vetëpunësimit dhe sipërmarrjes se lire tek të rinjtë duke ofruar mbështetje për vetëpunësim nëpërmjet programeve të nxitjes së start-ups.
- Bashkëpunim i afërt me donatorët me qëllim promovimin dhe zgjerimin e skemave të financimit për krijimin e sipërmarrjeve të reja, në përputhje me kërkesat dhe dinamikat rajonale të tregut.
- Divergjencia e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës me bazë gjinore, sjell një zhvillim jo të qëndrueshëm në periudhën afatgjatë, si rrjedhim politikave nxitëse të vetëpunësimit në vend duhet të marrin për bazë edhe përfshirjen gjinore.
- Përputhshmëri në krijimin e kurrikulave dhe kuotave të arsimit të lartë dhe trendeve të tregut të punës. Shqetësues është fakti që punëkërkuarit me arsim të lartë janë rritur gjatë tre viteve të fundit. Pra kjo mund të jetë një shenjë e mospërputhjes mes kërkesës dhe ofertës për kapitalin human të mirëarsimuar, gjë e cila kërkon ndërmarrjen e reformave strukturore të arsimit të lartë për të fokusuar nivelin e tretë të edukimit drejt profileve me interes të tregut.
- Duhet të koordinohen më mirë praktikave mësimore me tregun e punës. Tranzicioni nga institucionet arsimore në tregun e punës është një ndër vështirësitë kryesore të të rinjve dhe një ndër shkaqet e papunësisë së tyre. Pjesa dërrmuese e të rinjve që mbarojnë nivelin e tretë të edukimit nuk fillojnë punë në profilin e tyre dhe shpesh kanë vështirësi në gjetjen e punës që në momentin e përfundimit të studimeve. Drejtimi i politikave të praktikave mësimore duhet të jetë më i integruar me tregun e punës në mënyrë që të reduktoj gjetjen e kohës së punës pas përfundimit të studimeve e pse jo të lidhet drejtpërdrejt me vendin e praktikës.
- Një problem tjetër i cili ka ndikuar në papunësinë e të rinjve është edhe trajtimi teorik gjatë studimeve universitare duke mos i përfshirë në përvoja praktike dhe ti aftësoj për tregun e punës. Mungesa e praktikës në arsimin e mesëm dhe universitar në Shqipëri konsiderohet një nga shkaktarët kryesor të mos përfshirjes së kërkesës dhe ofertës në

tregun e punës. Në këtë aspekt duhet të ketë një përmirësim të kurrikulave mësimore në të dy nivelet për të pasur një përfshirje më praktike në procesin mësimor.

- Kompanitë duhet të ndërtojnë skemat e tyre të trajnimit dhe ritrajnimit të punonjësve në mënyrë që të mund të krijojnë forcë punëtore të kualifikuar dhe rrjedhimisht më produktive.
- Duhet të ndërmerren studime dhe analiza periodike të zhvillimeve dhe trendeve demografike dhe të tregut të punës në nivel bashkie dhe brenda tyre të zonave specifike.
- Rritje e bashkëpunimit institucional me Dhomat e Biznesit - duke i ftuar të bëhen pjesë efektive e rishikimit të kurrikulave të shkollave të mesme, qendrave trajnuese, ritrajnuese dhe universiteteve.
- Përdorimi i IT në rritjen e ofertës për punë e cila do të mundësoj një shkurtim të kohës së gjetjes së punës mes kërkuesve dhe ofruesve.
- Krijimi i një sistemi funksional pranë zyrave rajonale të punësimin në formën e zyrave me një ndalesë (one stop shop) ku bashkohet kërkesa e forcave të punës me ofertën për punë.
- Organizimi i konkurseve në nivel vendor për idetë novatore të bizneseve të reja dhe mbështetja financiare e tyre.
- Përdorimi i platformave bashkëkohore për biznese në fushën e turizmit dhe shitje - blerje në zonat e ndryshme të rajoneve.

Përkufizime¹⁸

Të punësuar konsiderohen personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Konsiderohen si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës. Të punësuar konsiderohen edhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmët që (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin / fermën / praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, janë konsideruar të punësuar.

Të papunë konsiderohen personat që gjatë javës së referencës ishin: 1. pa punë gjatë javës së referencës (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi; 2. aktualisht të disponueshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës); 3. duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.

Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

¹⁸ Shënim: Përkufizimet mbi treguesit e punës janë marrë nga INSTAT në:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab4>

Bibliografi

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Berat, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2310&token=2c0811b88546a89efd54b3932d5e5e663bcfbdb>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Cërrik, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2242&token=1f6bf72da737d8f720c265c3abc61d211a86f41e>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Dibër, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2220&token=715c74d27f351dd2bd07e01851faf2eeb868ed0c>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Divjakë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2234&token=796fd10ca4dff74ce1d39b76f3c09b412b6c0a7>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Elbasan, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2289&token=0767e91707e80fb62ada0b07f96b4b250939bb1c>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Fier, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2698&token=85d7cc7a6af08e55edd087a2ffa031b30ca71b4f>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Gjirokastër, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=1734&token=2433163acc9efe7f4270b28c66281df76ee1e4f7>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Himarë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3741&token=07131e9488a2e420f6880c03821371fb8a2af22d>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Konispol, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3713&token=c3ee13488978f2669019910d484333cba3cc1300>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Korçë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2200&token=4c67548869f3876c29a6aff44f70ed7609a6010>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Krujë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3983&token=fe3fb2f9ceb52aa26761a993451dcb0f7fb593dc>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kuçovë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2300&token=5f710ee90cc693170bec18a6e26ebcbbf433a68a>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kukës, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2209&token=6f96cd7cb8b3e6853dd10f126a301eace83d322e>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Librazhd, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3416&token=737b67c16ca17cd44b9d3824df995882c253c4ef>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushnje, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2324&token=67b075f976042a91a87d78449cc10d2be1645833>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Malësi e Madhe, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3872&token=2d12c8d4a63ef3585de1da25d7c545529438a789>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Mat, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=4017&token=8cf5477beefd6013183252fb24d9c7a35cf90c14>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Poliçan, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2154&token=99d95c0e9021750663e9c00830f06976de17297d>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Prrrenjas, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2250&token=c1383f12ce56334b702ed2f0629c99f42c12f9d3>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Rrogozhinë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3386&token=14fe00c26ea97b0ccaa1da35862f54dde13b3ed0>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Sarandë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3726&token=c0c42ad07bd5f1d0f8903af301f73541694be61b>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3907&token=cff20c1fadd4a40a00610dda2b8158166beb3a44>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Skrapar, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2128&token=841e35bd21139dff464f3748854b3f153b67c4c7>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=1730&token=e25abaef3f11df543632f27ab83f8f700979065e>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tropojë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3972&token=b516aefe32c176d35725cbc82975374243bc938c>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Ura Vajgurore, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2109&token=03147ac8641d403a76ac5e0fefdf799db2b5cecb8>

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë, 2017. E aksesueshme në:

<http://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=3459&token=6e7a4819566178a46b8b1aa579e24e6fd8c417af>

Banka Botërore (2018): *"Ballkani Perëndimor, Trendet e Tregut të Punës, 2018"*. The Vienna Institute for International Economic Studies. E aksesueshme:

<http://documents.worldbank.org/curated/en/565231521435487923/pdf/124354-WP-P158508-PUBLIC-16-3-2018-10-13-39-WBLabormarkettrends.pdf>

Banka Botërore (2018): "*Ndryshimi i Natyrës së Punës, 2018*". International Bank for Reconstruction and Development. E aksesueshme:

<https://elibrary.worldbank.org/doi/pdf/10.1596/978-1-4648-1328-3?download=true>

Banka Botërore, Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor (2006): "*Shqipëria: Një vlerësim i tregut të punës*". Tiranë. E aksesueshme:

<http://web.worldbank.org/archive/website01337/WEB/IMAGES/345970-2.PDF>

INSTAT dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (2013): "*Migracioni i kthimit dhe ri-integrimit*". Tiranë. E aksesueshme:

http://www.instat.gov.al/media/255790/migracioni_i_kthimit_dhe_ri-integrimi_2013_.pdf

INSTAT (2017), Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2016. E aksesueshme nw: <http://www.instat.gov.al/media/4342/pbb-rajonale-2016-shqip-njoftim-p%C3%ABr-media.pdf>

INSTAT (2017): "*Tregu i Punës, 2017*". Tiranë. E aksesueshme: HYPERLINK

"<http://instat.gov.al/media/4154/tregu-i-punes-2017.pdf>" <http://instat.gov.al/media/4154/tregu-i-punes-2017.pdf>

Instituti për Kërkim dhe Zhvillim CDI (2015): "*Trendet e Punësimit rinor në Shqipëri, Çfarë kërkon tregu?*". Tiranë. E aksesueshme: <http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2015/10/t-150427-text-al.pdf>

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (2014). *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020*. Tiranë. E aksesueshme:

http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Strategjia_per_Punesim_dhe_Aftesim_2014-2020.pdf

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (2016): "*Sfidat dhe mundësitë për punësimin e grupeve të marginalizuara nga ndërmarrjet sociale*". Tiranë. E aksesueshme:

<http://partnersalbania.org/News/konferenca-sfidat-dhe-mundesite-per-punesimin-e-grupeve-te-margjinalizuara-nga-ndermarrjet-sociale>

Shtetiweb.org dhe Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (2015). *Trendet e Punësimit Rinor në Shqipëri: Çfarë Kërkon Tregu?*. [online] Tiranë: Friedrich-Ebert-Stiftung. E aksesueshme:

<http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2015/10/t-150427-text-al.pdf>

